

Çështje

Libri polemizues për gruan e Muhamedit


Elestrime

Najbor rishkruan historinë e Shqipërisë

SAMI FRASHERI

Si vishej, ç' hante, kur shkruante...

Një portret me fakte të panjohura, një zbulim i plotë i pamjes fizike dhe asaj shpirtërore...



PROF. NASHO JORGAQI

Niazi Sulçe

Në fillim të viteve 80 mu dha rasti që të shkoja në Turqi dhe gjëja e parë që mendova ishte të shfrytëzoja këtë rast për t'i rënë në gjurmë jetës së vëllezërve Frashëri në Stamboll. Sigurisht, kjo nuk qe gjë e lehtë për shumë arsye, jo vetëm se nuk do të më premtonte koha, por kërkonte domosdo një përgatitje paraprake. Për këtë iu vura punës për t'u njohur me materiale të botuara në shtypin e kohëve të kaluara, dokumente që ruheshin në Arkivin e Shtetit, e sidomos kujtime të bashkëkohësve, veçanërisht ato të Lumo Skëndos.

→ Në faqen 2

Për Sami Frashërin, për ideologun dhe illumunis tin e lëvizjes sonë kombëtare të shekullit të kaluem, deri më tash janë botue vëllime të tana li brash, si në gjuhën turqishte, po ashtu edhe në gjuhën shqipe. Nëpër konferenca gjuhësore janë mbajtë dhe mbahen edhe kësaj dite e kendej me dhjetë e qinda ligjerata mbi jetën dhe mbi veprat e Sami Frashërit. Unë, kësaj here do të mundohem me cekë përkitazi mbi disa karakteristika kryesore nga jeta e këtij pinjollit të madh të lëvizjes sonë kombëtare Shqiptare, që deri më sot s'janë shkruet aq sa duhen nëpër këto vëllime të shumta të biografëve të Sami Frashërit.

→ Në faqen 3

Shtet

Ky është Vangjush Furxhi

NGA KIÇO BLUSHI

Grup

Historia e letërsisë s'është ndërrim gardistësh

NGA BEHAR GJOKA

Niveli

Nikolla Naço në letrat e Lagushit

NGA REBEKA MARTHA BURDA



Sami Frashëri, me fëmijet e vet në vitin 1898

Sami Frashëri parë nga afër

NIAZI SULÇE

Për Sami Frashërin, për ideologun dhe illuministin e lëvizjes sonë kombëtare të shekullit të kaluem, deri më tash janë botue vëllime të tana librash, si në gjuhën turqishte, po ashtu edhe në gjuhën shqipe. Një konferenca gjuhësore janë mbajtë dhe mbahen edhe kësaj dite e kendej me dhjetë e qinda ligjerata mbi jetën dhe mbi veprat e Sami Frashërit.

Unë, kësaj here do të mundohem me cekë përkritazi mbi disa karakteristika kryesore nga jeta e këtij pinjollit të madh të lëvizjes sonë kombëtare Shqiptare, që deri më sot s'janë shkruar aq sa duhen nëpër këto vëllime të shumta të biografëve të Sami Frashërit.

Samiu, si pohojnë dhe tregojnë shumë vetë, t'afërmit dhe të njohshmit: ka pasë shtatin e gjatë dhe të përkulun me bel të hollë, me ball të gjanë dhe pak të dalun përjash-ta. Ngjyrën e syve i ka pasë të zezë dhe shumë të shkëlqyeshme. Mjekra e bardhë dhe e pastër, prej mollzave teposhtë i ka fillue m'u zvarrë. Flokët, vetëm në tepe, pakës i kanë fillue me i ra. Prej punës së pa-lodhëshme dhe intensive, tue mos dhanë pushim vehtes, si shendetin e vetë që e ka dobësue, ashtu edhe prej moshës në dukje të parë, asht tregue pak ma i vjetër. Si në shtëpi, ashtu edhe në shoqni, gjithmonë serioz, dhe në të folun i ambël dhe buzagaz ka qenë. Askënd, në çfarëdo rasti që të jetë, nuk e ka ngucë kurr në të folun. Ndjaj gjithëkujt xhentil dhe modest asht tregue. Në pamje të parë e mandej, në sejcilin person ka ngjallë respect e dashuni të thellë.


Gjatë bisedimeve miqësore, mendimet e të tjerëve ka ndëgjue

#shqiptar


Samiu, si ndaj të tjerëve, ashtu edhe ndaj familjes, e sidomos ndaj anëtarëve të shtëpis ka qenë shumë i respektueshëm. Kërkënd nuk ka pasë në zemër për m'e zemrue, sa që edhe ndaj shërbëtorëve asht ruejtë shum për mos m'e fye në ndogja.

Siç qmiv

Samiu, në ditën pak para vdekjes, vajzës së vetë: "Më lexo pak prej Gazilellës", paska lutë. Edhe ajo babës së vetë, prej librit një pjesë të dashme e paska lexue. Samiu, tue dhanë shpirt, prej buzëve të veta vetëm këto dy fjalë paska pëshpëritë: "Shqipëri" dhe "Allah".



Sami Frashëri, Stamboll 1888



me vëmendje shumë të madhe. Tue pasë respect të thellë ndaj çdo lloj mendimi, edhe me qenësë s'asht pajtue me atë mendim, deri në fund mbasi që ka ndëgjue, tue shtue: "Keni plotsisht të drejtë, vetëm se unë me tamam nuk pajtohem me mendimin e juej", ka shtue mbas pak. Mendimet e veta, me të drejtë, pa imponim deri në fund ka mbrojtë. Ndonjherë nëpër polemika kur hynte, nga inati, edhe tue mos qenë në vijën e drejtë, me lehtësi ka muejtë me dalë në krye.

Samiu, si ndaj të tjerëve, ashtu edhe ndaj familjes, e sidomos ndaj anëtarëve të shtëpis ka qenë shumë i respektueshëm. Kërkënd nuk ka pasë në zemër për m'e zemrue, sa që edhe ndaj shërbëtorëve asht ruejtë shum për mos m'e fye në ndogja. Në kohën kur asht nxë e polemizue në bisedë, ndaj kundërshtarit: "Shum mbarë po bani", me të thanëmen asht mjaftue. Në çfarëdo bisedë që të jetë, gjithmonë më za t'ulët ka pasë dëshirë të ndëgjonte ndonjfarë zhurme. Ndonjani prej shkallëve me poterë nëse ka dalë, apo nëse ka zdrypë, menjëherë Samiu ka vrapue te dera: "Çka po bahet? Mos po digjet gjja? Ka pyetë."

Pa pastërtin, parregullinë, shpërndamjen e teshave aty-këtu, aspak nuk ka pëlque. Njëpër kambë, as ndonji letër të vogël të shkryeme nuk ka përballue për m'e pa. Mandej, as ma të voglën mahi nuk e ka pasë në zemër për m'e ndie.

Samiu, ndaj jetës së re menjëherë kambë ka ndrrue, si me thanë me mall ka përqafue. Mbrapambetuninë gjithmonë ka luftue me të gjitha forcat e veta. Jetën e lirë dhe të njerëzishme gjithmonë ka lakmue dhe ka vue vehtes për princip ashtu me jetue. Ndjaj modes së re dhe përtrimjes gjithmonë ka shkue, krah për krah. Moden, jo vetëm për-



lexopl
Faktet

Ka pasë shtatin e gjatë dhe të përkulun me bel të hollë, me ball të gjanë dhe pak të dalun përjashta. Ngjyrën e syve i ka pasë të zezë dhe shumë të shkëlqyeshme.



Sami Frashëri, me të shoqen Emine Veliye

→ Vijn nga faqja 3

jashta, por edhe mbrenda shtëpis ka ditë të mrekulli për me aplikue. Në të veshun, në jetën komode, me veprime e me gjeste edhe ndaj fëmijëve të vetë çdo herë ka qenë si shembelltyrë. Samium jo përjashta, por as brenda, me bizhame kurkush nuk e ka pa tue u endë. Samiu, në shtëpi, gjatë verës, një këmishë me jaka të tërhequna dhe të mbyllëta ka veshë. Ndërsa kambëva, nëpër shtëpi gjithëkush shihte tue veshë një palë pupuqe ku pjesa e mbrapme ishte e mëshelun. Gjatë dimnit, një mantil të zi dhe shumë të gjatë, apo herë mbas here, një palltë në formë të xhypsës, edhe kjo e ngjyrës së zezë, e gjatë dhe e bollshëmë shiheshite që e veshite. Herkë, më qenëse s'ka pasë në qeif, asnjihërë nuk e ka veshë. Po ashtu edhe sendet e mëndafshita ka pasë shumë mëni për me veshë. Në shtrat në jorgan nuk asht mbulue. As batanijen nuk e ka përdorë asnjihërë.

Me qenëse ka qenë smuet ngapak shëndetit të vet, Samiu ka dhanë kujdesë të veçantë. Për ditë kryet dhe fytyren me ujë të ftofët, e mjekrën e gjatë dhe të bardhë me sapun e ka fërkue dhe e ka la. Në rojtore shumë rrallë ka shkue. Mjekra me t'u rritur vetë me gërshanë e ka pre dhe e ka ujdisë. Në dhomën e punës dhe të fjetjes, ditë e natë pa rreshtun stufen e ka ndezë.


Samiu, ndaj të gjithë fëmijve, e sidomos fëmijve të vetë, ka qenë shumë i kujdesshëm. Për rrethë edukimit të tyne, çdo sakrificë ka tregue. Për dhanje të mësimimit profesora specialë ka nshanë. Për dhanje të gjuhënave arabishte e frengjishte nergut prej Algjeris ka nshanë njëfarë Mesut Efendiun. Ndërsa mësues i gjuhës turqishte, Abdurrahman Efendinë vinte. Për mësimet e vizatimit, të punëdorës e për mësimet e muzikës (pianjos), të tjera profesore në shtëpi i kanë ardhë. Dhe vetë Samiu, n'atë kohë procedimin e të dhanunit mësim nëpër shkolla tue mos e pëlqye, djalin e vetë, sportistin gjenial të ma vonëshëm të Turqis, Ali Samiun, tue mos e que në shkollë, në shtëpi vetë ka fillue m'e eduku. Por, prej lutjeve të shumta të baxhanakut, të mjekut Xhelal Ismail Pashës në një anë, dhe n'anë tjetër edhe të nipit, ish ministrit të punëve të jashtëme, të Safa Beut, disi Samiun e kandisen dhe kështu djalin Ali Samiun, ka fillue m'e dërgue në shkollën më të mirë, n'atë të Galatasarajit në Stamboll.

Samiu, edhe me gjithë admirimin e dashurin e pa-kufishme që ka ndie për fëmij, ata, përveç kohës së bukës, vetëm gjatë orëve të duhura të ditës i thirrretë pranë vhtes, ku edhe ata, si fëmij ma, i vijshin sa ora, turr e vrap, me plot gaz e gëzim në zemër.

Sami FRASHERI parë nga afër



Samiu me dy vëllezërit Mehmetin dhe Tahsin



Samî Frashëri në dhomën e vet të punës 1897

Samiu, ndaj tyne, gjithmonë me matuni shumë të madhe ka folë e ka bisedue me ta.

Me qenëse gjatë kohës së pleqnis, ka lenue shumë prej smundjes së shiatikut, në shtëpi, të shtatë fëmijit me rradhë, i kanë friksionue kambët e Samiut. Në mbramane, në orët e shprazëta, shumë herë vajzës së vetë ka lutë që të lexonte copa prej Viktor Hygos, apo prej vargjeve të bukura të Lamartinit. Ku edhe ajo, me plot dëshirë, deri në fjetje, rrinte tue lexue babës së vetë shumë të dashun.

Ma vonë, kur asht ndalue dalëja e Samiut nëpër rrugë, vetëm dy herë në muej, kanë pa tue dalë prej shtëpis, shumë i menduem dhe të mërzitun prej halleve të shumta të jetës.

Dalja me familje nëpër rrugë, dhe mandej hypëja nëpër qerre ndamas të grave e të burrave, Samiun pa masë e ka zemrue.

Jeta familjare e Samiut, larg prej disharmonis larg prej thashë e thanëveve të hallkut; jetë modeste dhe shumë pastër ka kalue.

Si çdo kush, edhe Samiu ka pasë lloj-lloj dëshirash, shprehinash dhe një memorje shumë të fortë çpikëse. Të vizatimit edhe me qenëse nuk ka ditë, por kaliografim e të shkruemit e ka pasë jashtëzakonisht shumë të bukur. Kjo shihet qartë nga korrespondenca që ka pasë me shumë miq, nga të katër anët e botës. Shum tabela të dyqaneve dhe të shitoreve, vetë Samiu ka pregaditë. Edhe kompozicionet e kopërtinave të të gjitha veprave të veta vetë i ka hartue. Përpos këtyne, edhe klishet e tyne. Mandej, planin e qyshkut ku ka banue n'Erenkoj, kush thueni që ka mbarue? Vetë Samiu me dorën e vetë. Mandej edhe maqinën daktillografike me shkronja arabe, vetë ka ujdisë. Zejën e zdruktaris me qenëse e ka pëlqye shumë, në kopsh-tin e qyshkut të vetë edhe shumë pemë ka mbjellë dhe e ka shartue. Llamblën me gaz nuk e ka përdorë asnjihërë, natën nën dritën e qiritu ka pasë shumë dëshirë me shkruë.

Samiu perimet nuk i ka pëlqye. As vojnin e ullinit, as pilafin në gojë nuk e ka shtie. Prej hëve ma së shumti çorben, henat me spanaqë, me zela, me tambël e me djathë shumë i ka pëlqye. Cigaretar nuk e ka përdorë për tanë jetën. As lojën e letrave nuk e ka pëlqye. Samiu, edhe fëmi kur ka qenë, aq shumë me shokët e mahallës, apo me të tjerë fëmij nuk ka luejtë. Vetëm libra tue lexue, qysh në fëmijni ka pasë dëshirë të flakët m'u ba dijetar. Ende tue qenë në moshën 8-10 vjeçare, veshjen e hoxhallarëve tue kopjue, ashtu gadi për çdo ditë ka shetitë.

Romane me lexue nuk ka pasë aq shumë dëshirë. Mirëpo, me gjithë këtë, edhe vetë


Si çdo kush, edhe Samiu ka pasë lloj-lloj dëshirash, shprehinash dhe një memorje shumë të fortë çpikëse. Të vizatuemit edhe me qenëse nuk ka dijtë, por kaliografin e të shkruemit e ka pasë jashtëzakonisht shumë të bukur.

Këtu

Mandej edhe maqinën daktilografike me shkronja arabe, vetë ka ujdisë. Zeyën e zdukris me qenëse e ka pëlqye shumë, në kopshin e qyskut të vetë edhe shumë pemë ka mbjellë dhe e ka shartue. Lambën me gaz nuk e ka përdorë asnjherë, natën nën dritën e qiriut ka pasë shumë dëshirë me shkruere.

Vërtet

Samiu perimet nuk i ka pëlqye. As vojnin e ullinit, as pilafin në gojë nuk e ka shtie. Prej hëve ma së shumti çorben, henat me spanaqë, me zela, me tambël e me djathë shumë i ka pëlqye. Cigaren nuk e ka përdorë për tanë jetën. As lojën e letrave nuk e ka pëlqye



Shtëpia Eren-qoj ku ai vdiq më 18 qershor 1904, kjo shtëpi u projektua nga vetë Samiu

Çmendur

Samiu, ka pasë zakon që shkrimet të shkruente nëpër letra ngjyrë të kaltërtë të mbyllët. Këto i ka pre për së gjati dhe ashtu ka shkruere. Nëpër skeje të letrave, gjithmonë: "notizime marzhinale" mbsi që ka shkruere, e ka kthye mbrapa

Qëndrues

Në shkrimet e përditëshme ka përdorë gjithmonë ngjyrën e zezë. Ndërsa titullin e shkrimit ka shkruere me ngjyrë të kuqe. E notizimet që ka kthye mbrapa, janë shkruere me ngjyrë të kaltërtë. Këto ngjyra, që të mos përzihen shkrimet njana me tjetrën, i ka përdorë me dashje

romane ka shkruere, dhe shumë të tjera, prej gjuhënave të hueja edhe i ka përkthye. Prej romancierëve, ma së shumti shkrimtarët e letërsis franceze dhe angleze, si dhe tregimet e letrarëve të rij i ka pëlqye. Për ta: "Këta shumë do të përparojnë, vetëm nëse vazhdojnë me shkruere në gjuhën e tyre të pastër amnore dhe letrare" – ka thanë.

Dëshira ma e madhe e Samiut ka qenë që numrin e veprave të veta m'ë nxjerrë në njëqint. Mandej revistat: "Toka dhe Qielli", pa nda me nxjerrë. Në jetë, e vetëmja dëshirë e zjarrtë, vetëm niherë me dalë një shëtitës nëpër Kinë e Hindi.

Mënyrë e punës ditore të Samiut asht kështu: Ai, çdo mëngjes shumë herët, me t'u zbardhun drita asht çue. Menjherë stufën e dhomës e ka ndëzë, shtrouen mbasi që ka rregullue, deri në të lëmun të diellit vetëm ka punue.

Shkrimet e pregadituna me Llallën mbasi që i ka dërgue në shtypshkronjë, çajin vetë me dorë e ka nxe. Mbas kafjellit një orë të tanë mbasi që ka pushue, prap të shkruemit ka vazhdu, deri në mesditë vetëm ka punue.

Në bukën e drekës me zilë asht thirrë. Në sofër, gadi gjithmonë vetë i mbrami ka zhdrypë. Mbas të granunit të bukës, nja dy orë ka pushue. Mandej prap punës ia ka fillue. Afër mbramjes, mbasi që ka krye të shkruemunit, një kupë të vogël me konjak ka marrë. Ndërmjet kupës së konjakut dhe të bukës së mbramjes, vetëm një çaj ka pie. Mandej deri në ngranje vetëm ka bisedue. Gjatë kohës së dimnit, për m'u nxe, këtij çajit pak konjak i ka shtue. Ndërsa gjatë ditëve të nxehta të verës, herë mbas here, deri në "çiftehavuzlar" ka shkue. Aty, në shoqni, një kupë të madhe me plot shkuma të birës ka pie. Të ngranunit bukë në mbramje me orë ka zgjatë. Mbas bukës mbramnore aspak s'ka punue. Nëkohën kur s'ka pasë vizitues, herët ka ra me fletjë. Samiut herë mbas here, vizitues prej vendeve t'Afganis, Hindis, prej Egjiptit, prej Persis e Hungaris i kanë ardhë. Këta shpesh herë kanë ardhë edhe për darkë. Samiu me ta, në gjuhen e vendit të tyre u ka dhanë përgjigjen prej miqëve shqiptar me së shumti Vaso Pasha, Jani Vretoja dhe shumë shqiptar prej vendeve të jashtme kanë ardhë. Ndërsa prej miqëve vendas, ma së shumti i kanë ardhë Veletin Çelebiu, Nexhip Asimi dhe poeti Mehmet Xhelali.

Nga të katër anët e botës, Samiut, në shtatë gjuhëna letra i kanë ardhë. Postierët për Samiun, thojsin se ishte njeriu që merrte ma së shumti letra n'atë kohë në Stamboll. Edhe vetë ai, shumë letra në ditë ka shkruere.

Një ditë, tue dyshue, të gjitha letrat i paskanë marrë, si dhe vetë Samiun i paskanë marrë në hetime. Kur i kanë ndalue vizitorët për me shkue në shtëpi të Samiut, atëherë kurkush nuk paska guxue me trokitë, veç shqiptarëve në shtëpi të tij.

Kur ka qenë Samiu tue shkruere, kurrkush në dhomën e tij nuk ka guxue me hye. Vetëm macës së madhe dhe të larme që shumë e donte, shtirimjes së saj afër kambëve të veta, për këtë nuk ka nxjerrë fare zanin.

Samiu, ka pasë zakon që shkrimet të shkruente nëpër letra ngjyrë të kaltërtë të mbyllët. Këto i ka pre për së gjati dhe ashtu ka shkruere. Nëpër skeje të letrave, gjithmonë: "notizime marzhinale" mbsi që ka shkruere, e ka kthye mbrapa. Në shkrimet e përditëshme ka përdorë gjithmonë ngjyrën e zezë. Ndërsa titullin e shkrimit ka shkruere me ngjyrë të kuqe. E notizimet që ka kthye mbrapa, janë shkruere me ngjyrë të kaltërtë. Këto ngjyra, që të mos përzihen shkrimet njana me tjetrën, i ka përdorë me dashje.

Shkrimet e veta, Samiu, ka shkruere shumë bukur, të lexueshëm dhe kuptimplotë. Këto shkrime t'shkrueme, Samiu s'ka pasë zakon të rilexoj përsëri, ashtu tu bë i ka dërgue menjherë në shtypshkronjë.

Prej veprave të mbëdhja dhe të vogla, sa ka shkruere, Samiut, gazetave që i ka dërgue herë mbas here; prej këtyne shkrimeve shumë pak të holla i ka hye në dorë. Me këto të holla, Samiu shpenzimet ditore dhe indigencat e tjera familjare, me shum vështirësi ka përballue. Mandej, për shkak të mbarrimit të qyskut të ri n'Erenkoj (në Xhade-

bostan) edhe shumë në borxhe ka hye. Sa që edhe shtëpin e re si rehinë ka lanë. Përveç kësaj, edhe për libra që ka prue prej së jashtëmi, vetëm për këto, edhe 1500 lira të tjera në borxh përsëri ka hye. Ndërsa rroga mujore që ka marrë n'atë kohë Samiu prej detyrës zyrtare, edhe atë në kohët e fundit, ka qenë vetëm 50 lira. Këto të holla që ka marrë, medoemos të gjitha nevojat familjare nuk i ka përballue. Veç rrogës, Samiut, burim i vetëm për me mbetë gjallë ka qenë t'ardhurat nga veprat.

Edhe tue qenë kështu, në këto kondita ka qenë vështira tue jetue, Samiu prap se prap, veprat e veta nuk ka shkruere për me fitue të holla, por për ideal, edhe atë për ideal të njerzimit. Ma na fund, në kohën kur ka nxjerrë gazetën e përditëshme "Sabah" (Mëngjezi), gazetata e tjera ditore edhe pse shiteshin për 40 pare, Samiu, cmimin e gazetës së vetë, për me pasë lexues ma tepër, për 10 pare ma ulet e ka zhdrypë.

Edhe veprat e mavonëshme, që kanë vlef të shkencore, gjuhësore e kombëtare, edhe këto nuk ka nxjerrë për fitesë, por, me qenë i dobishëm, me i shërbye ma tepër popullit shqiptar. Samiut, inspirimi dhe influenca e vetme që detyrue për me shkruere këto vepra gjennale, asht dëshira e flakët dhe pasioni i çjenikët që ka pasë për me shkruere për atdhe.

Veprat e Samiut që e ka shtyp n'atë kohë dhe gazeta "Sabah", pronari i ma vonëshëm i saj ka qenë Mihrani. E ky person, n'atë kohë në Babilai, asht i njoftun si njeri shumë dorështrënguet. Mihrani, me kohë të hollat e shkrimeve të Samiut tue mos i pague, Sa-

miun e ka shtie në shumë shtrëngesa, të mbëdhja. Sa që shumë herë edhe e ka turbullue e revolue shumë Samiun. Mihrani, kur Samiun sulltani e ka çue si syrgjyn të Trabulgarb, dhe ma vonë në mbarrimin e qyskut n'Erenkoj, thashë e thanëmet që fliteshin ndër popull se Mihrani ka ndihmue Samiun, këto nuk kanë baza të shëndosha dhe nuk janë aspak të vërteta.

Samiu prej fjalorit të famëshëm dhe të parë frengjisht-turqisht, në dorë me saktësi sa të holla i kanë hye, aç mirë nuk dihet. Mirëpo, prej shkencave natyrore në krye të formës (e forma me qenëse përmbanë 16 faqe), prej Mihranit ka marrë vetëm 3 lira. Ndërsa prej volumit të fundit që s'ka marrë kurrnjë pare, këtë antarët e familjes së tij e dëshmojnë. Vepra "Shkencat Natyrore" së pari asht parapa të dali në 5 volume, por më vonë tue pa se kjo nuk mjaftonte, edhe shite e të gjashtit volum ka qenë i pa evitueshëm. Prej abonimeve të shumta që ka shkruere n'atë kohë gazeta "Sabah", shihet qartë se Samiu prej volumit të fundit s'ka marrë asnjë pare. Mundë të bahet, që Mihrani tue mos marrë prej abonuesve të holla për ket volum, edhe Samiut natyrisht nuk i ka dhanë. Prej fjalorit të gjuhës turqishte, Samiu prej Ahmet Xhevdetit, në krye të formës, ka marrë 5 lira, që n'atë kohë mundë të numrohet si niveli ma i naltë që ka marrë Samiu n'atë kohë prej të gjitha veprave të veta.

Samiu, në kohët e fundit të jetës, për të holla shumë shtrëngesa të mëdha ka hekë. Për 500 lira qyskun e mbaruum ka dhanë për rehinë. Me qenëse borxhin me kohë nuk e ka pague, hisedarët edhe qyskun në shitje e kanë nxjerrë. Për këtë, Samiu aç shumë genka dëshprue, sa që edhe goja ju paska marrë. Rrafsh dy ditë të plota nuk paska muejtë me folë. Qyskun lirë për me ble, edhe Ragip Pasha musallat genka ba. Mbas vdekjes së Samiut, mbas pak Ragip Pasha qyskun e paska ble, dhe familjes së tij, për m'u bajtë, vetëm 24 orë afat i paska dhanë. Afati me t'u osoun, fëmijë e Samiut, genkanë detyrue që teshat e shtëpis m'ë bajtë n'oborrin e xhamis.

Edhe biblioteka e pasun e Samiut mbas vdekjes, për 800 lira genka nxjerrë në shitje. Një pjesë të këtyne veprave të çmueshme Zyherzade Ahmet Pasha, dhe pjesën tjetër Ahmet Xhevdeti paska ble.

Samiu, në ditën pak para vdekjes, vajzës së vetë: "Më lexo pak prej Gazilellës", paska lutë. Edhe ajo babës së vetë, prej librit një pjesë të dashme e paska lexue. Samiut, tue dhanë shpirt, prej buzëve të veta vetëm këto dy fjalë paska pëshpëritë: "Shqipëri" dhe "Allah".



Srdhplm mbi rishkrimin

Rrekja mjerane, e gjer më tash vetëm e pëshpëritur nën zë, për të kundruar dhe shqyrtuar si letërsi bashkëkohore vetëm autorët dhe librat e botuara rreth dhe pas viteve 90', të cilët rezultojnë edhe çmim-fituesit më të mëdhenj të kësaj kohe, w#pexixu#h#hgimulwh#chwdu/ixk#gh#eacghlnv|qilqit#hwthlwlpwdu#w#pghy#h#w#ovkxdu/#p#kxp#vkt#ulv#gh#solvinkw#h#ch#wlwinkw/w#w#wkzkgh#p#k#wulq#h#chwulv/#p#wpscolq#h#yhdh#jmlwknk#gh#jmlwkd#svlqgh

HISTORIA E LETËRSISË nuk është ndërrim gardistësh

BEHAR GJOKA

Kryetemë e mjedisave akademike, mediatike, politike, poetike dhe atyre që nuk kanë asnjë lidhje me letërsinë, prej disa javësh dhe muajsh, është bërë shkrimi ose mos shkrimi i historisë së letërsisë shqipe. Shumëkush, së paku nga ajo që është shkruar e zeza në të bardhë, sa i përket këtij momenti, thelbësor për ekzistencën e letrave shqipe, në këtë tolloni llapashitjeje pa shumë logjikë dhe përgjegjësi, rreket që vetëm sa të rrëmbejë flamurin e bërjes ose të mosbërjes së kësaj historie, pra realisht të zhbërjes edhe ca më tepër të asaj, që tani po rropaten ta shpallin si Bibël apo Kur'an shpëtimtar për letërsinë shqipe. Në fakt libri për letrat shqipe, gjithkohore dhe gjithpëpësinore, nuk ka arsye të mjaftueshme që të kundrohet dhe përftohet si një libër hyjnor, shkrimi ose mosshkrimi i të cilit lë vjerrë letraren dhe ekzistencën e saj. Vështrimi dhe përjetimi kështu vetëm sa ndikon për ta fetishizuar këtë akt dhe për të humbur përgjegjësinë e institucioneve përkatëse, që ta kishin zënë fillin e punëve me kohë. E drejta për të hyrë në këtë debat është e kujt,do, pavarësisht idesë dhe krahinës, besimit fetar dhe moshës, titujmbajtjes dhe çmim-fitueses, mungesës dhe aspiratës për t'i pasur ato ofiqe, pa peshë specifike në raport me letraren, porse askush nuk ka të drejtën e përjashtimit të faktorëve, letrarë dhe shkencorë, sipas kritereve të zyrtarshëm ose të pazyrtarshëm, të klanit të qeverisë apo antiqeverisë, të gardizmit të hershëm ose antigardizmit të ri, në kontributin e rishkrimit të Historisë së Letërsisë. Debat i përmbi shkrim-mos-shkrimin e Historisë

së Letërsisë, sepse ka më shumë gjasë që të mbetemi në vend-numëro në këtë sipërmarrje, duket qartë se ka rreshqitur në binarët e ndarjeve dhe hapërndarjeve të zakonshme, madje krejt të rëndomta që ndodhin çdo ditë me ne shqiptarët, e të gjitha anëve të kufirit, ku "halli" më i madh, si më thënë halli përmbi të gjitha hallet, çka sugjerohet më tepër, është që mungesat e pranishme në shkrimin e historisë, gjer më tani të zëvendësohen me mungesa të tjera, mbase më të mëdha, mediokritetit ta përmbysim në një mediokritet ca më gjigand, paprarinë e letrare ta shndërrim në mungim të plotë të saj. Rrishtas, si kurdoherë në raste debatesh pabukëse, në mungesë të ideve dhe gjykimeve përbashkuese, kampet janë ndarë në dy grupe të mëdha, pa asnjë shenjë se edhe mundet të shkrihen akujt, ndërmjetshëm për të komunikuar së çfarë mund të mendohet dhe ideohet përmbi letraren. Ndarja e tyre bëhet e prekshe me njëherë, kur sheh frymën e pranishme.

A- Grupimi i nostalgjikëve, që më tepër se sa shqetësimin e shkencës së Historisë së Letërsisë, merakoset për përfundimet e njëanshme të studimitarëve zyrtarë të shqipes, të kryera atëherë, për konkuzionet me gjurmë shkencore të munguara, të shkencës dhe shkencëtarëve që e kundruan letraren e të gjitha kohërave me lënten e përjashtimit të modeleve, që nuk i bënin hasana sorealizmit dhe sistemit diktatorial. Ky grupim, jo fort i vogël, përbehet kryesisht nga akademikët, e vjetër dhe të ri, nga titujmbajtësit e shkencës letrare sociologjike dhe ideologjike, e më tej gjitha këtyre rrafshëve, që nisur vetëm nga kriteret e niveleve jashtëletrare, ndihmoi në përzënjën me pantooni i letrave shqipe të **Fishtës, Konicës, Santorit, Haxhiademit, Skiroit, Kolliqit** etj., që lexoi me syzet e kufizimeve ideore, papërshtatim të gjitha periudhat e letërsisë shqipe, qysh me letërsinë e shekujve XVI-XVII, me **Buzukun, Budin, Matrangën, Bardhin, Bogda-**



nin etj., që shpërfilli krijimtarinë e **L. Poradecit** dhe **M. Kutelit**. Tek këta, me heshtje dhe bërtitma, lëshohen tullumbacet e radhës se po shkatërrohet historia, se po bien poshtë punët e mira të bëra në vitet para përmbyjes së diktaturës, se po nëpërkëmbet letërsia e lartësive të "maleve të papushueshëm" të Realizmit Socialist. Nuk është vendi e as nevojia që të ndalesh gjatë në këtë mediokritet të "ndritshëm" të shërbesës ndaj rendit dhe ideologjisë komuniste, por akademikët e nivelit të rënies nga fiku, por edhe të hipjes nëpër fiq të rinj, së paku të kërkojnë ndjesë, njëherë të vetme, për mashtrimin dhe vetëmashtrimin që endën me atë historinë e përjashtimeve letrare, të teksteve dhe autorëve të shumtë, lënë në harresë, mbi bazën e parimeve jashtëletrare të ideologjive dogmatike të kohës së mosgenies sonë.

B- Grupimi i dytë, paksa më radikal se sa i pari, në vullnet dhe energji, në ego dhe determinim të hapësirave të "Iirisë" dhe të gjithçkaje që ka krijuar ajo, përbëhet nga ata që vijnë në skenë me psikologjinë e vitit zero, e atij vitit kur bota fillon pikërisht me ata, në këto punët e letrave, dhe gjithë pjesa tjetër, pra etapat e mëparshme, madje edhe ato vlera të pranishme në modelin zyrtar, janë pa pikën e vlerës përballë zbulimit të "gjenive" të tanishëm. Përbërja e tyre është paksa më mikse dhe më ndërlëkuar nga grupimi i parë, sepse aty janë të përfshirë një tip shkrimtarësh, që meqenëse janë të pushtetshëm, deputet apo kandidat për ministra apo kryeministra, duhet të udhëheqin edhe në lëmin e letrave, gjithnjë si pararojë, praparojë dhe anashrojë e shoqërisë njerëzore shqiptare. Ata dhe askush tjetër duhet të heqin udhën

e aspekteve shpirtërore, aq të çmuara për lirinë ku edhe gjendemi. Pjesë thelbësore e grupimit, të sfidantëve që do të shkruajnë historinë e letërsisë me çdo çmim dhe mënyrë, e cila kërkon ndalimin e orëve dhe nisjen e një "bote të re" në sferën shpirtërore, në emër të faktit që kanë fituar gjithë çmimet e shpërndara, pa doganë dhe më tepri, këtyre viteve të "rrumpallës" letrare, që kanë përfutur të gjitha ndihmat dhe tenderat e ministrive të arsim-kulturës, që i kanë marrë titujt në mënyrat më të paimagjinueshme të mundshme, të studiuave të parathënieve dhe pasthënieve, pra të njerëzve që rrojnë në pushtetin dhe mjelin pushtetin, në emër të famës dhe egoizmit personal, dhe duke e futur procesin e rishkrimit dhe diskutimit të historisë së letërsisë shqipe, në molonë e mediokritetit, ku megjithatë notojmë krenarë dhe me vizion për t'u mbytur me një pikë uji, si përherë.

Në këtë situatë të përjashtimit të skajshëm, ku nuk vezullit asnjë hije shprese dhe besimi, se debati dhe diskutimet mund të bëhen, pak më të hapura dhe me tejshpërmbërje, pak më me kulturë dhe me vështrim shkencor, pak më letrare dhe më bindjen se po kryejmë një akt të nevojshëm, për hir të letrares, në këto rrethana është e vështirë të heshtësh, por përsëri është pa vlerë të flasësh në kurriz të letrares, siç edhe ia mbysin në tym analistët e gjithdijes. Shkrimi i historisë, sidomos i historisë së letrares është një proces i hapur, është një rruginë ku secili brez, i duhet ta njohë dhe rishkruajë historinë, si përjetim dhe vlerësim, verifikim dhe prejkje e vlerave të të gjitha periudhave, është një akt që nuk përjashton faktorët e ndryshëm, përkundrazi i përbashkon dhe arrin që të sendër-



tojë një tekst, me jetëgjatësi dhe prani vlerash letrare, dhe jo me përjashtime dhe harrësa të tyre. Shkrimi apo rishkrimi i historisë së letërsisë, i plotë ose i pjesshëm, formal ose përmbajtësor, i rrymave dhe shprehësisë letrare, individual ose tërësor, nuk është një akt verbal, si me thënë një ndërrim i thjeshtë i "garderobës" me ndërrimin e motit dhe stinëve. Ky akt, pra shkrimi i një historie letrare, qysh me zanafillën e letrares e gjer në ditët e sotme, shkencore dhe e panashme, përpara se sa të miratohet fondi nga qeveria dhe specialistët e qeverisshëm, çka edhe historinë e letërsisë e rrëshqet në binarët e tenderave të përherëshëm, përpara se të formohej grupi i punës, më tepër në fshehtësi ilegale, pa e kuptuar dot pse-në e shakaqeve të këtij veprimi në kushtet e demokracisë dhe lirisë së shprehjes, përpara se sa në linjë të përgjithshme, të bëhej ndarja e grupeve të autorëve që do të merren me secilin periudhë dhe tekst letrar, duheshin shtruar në parim dhe për diskutim disa çështje, që në shijen dhe gjykimin tim, do t'i hapnin udhë debatit të gjerë dhe të specializuar të fatit të historisë së letërsisë shqipe:

Së pari: A duhet rishkruar historia e letërsisë shqipe? Për një mendje të shëndoshë në punët e letrave, jemi pak të vonuar në këtë aspekt, i cili normalisht duhet të ishte në tryezën e punës të doktor-profesorëve tanë, qysh në mbarim të viteve '90', jo se letrarja dhe studimi i saj ndjekin proceset politike dhe sociale, porse arti dhe kultura e mëparshme ishin përdorur dhe shpërdoruar si shërbëtare e sistemit dhe ideologjisë në fuqi, dhe pastrimi i letrares nga "mbetjet" jashtëletrare është i nevojshëm dhe i pashmangshëm, sidomos prej kë-

tyre rrethanave specifike të ekzistencës së letrave shqipe. Por vonesa e tejzgjatuar në aspektin e verifikimit, tashmë vetëm me lënten letrare, nuk justifikon ngutën dhe zellin e tanishëm, për të kryer me shpejtësi rrufeje këtë akt, që druasë do të realizonte edhe një histori tjetër "përjashtimesh" të vlerave letrare, çka vetëm sa do ta ndërlikonte edhe ca më tepër shkrimin dhe rishkrimin e historisë reale të letrave shqipe. Shkrimi apo rishkrimi i historisë së letërsisë, në fakt kërkon hulumtime dhe shqyrtime shkencore, të thelluara dhe të vazhdueshme, pa mënjanim nga ky proces asnjë faktorë letrarë dhe shkencorë, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Së dyti: Cili është roli i mjedisve institucionale dhe i atyre individuale, në procesin e shkrimit të historisë së letërsisë shqipe? Më e mira do të ishte që këto dy faktorë të rëndësishëm, të ishin në bashkëveprim dhe mirëkuptim të ndërmjetshëm. Jemi në Shqipëri, të mos e harrojmë këtë rrethanë, dhe siç është bërë rregull i pashkruar, tashmë pjesa institucionale, ku futen Akademia, Fakulteti, Instituti i Gjuhës dhe Letërsisë, i Albanologjisë, e patjetër edhe grupime jashtë tyre, siç është Albshkenca, kryesisht japin direktiva të pafundme se si e qysh na u dashkërka bërë historia e letërsisë në këto kohët e reja, si me thënë institucionajla bën projektin dhe tenderin, e studiuesit, brenda dhe jashtë institucioneve dhe shoqatave, kudo që të jenë, nuk kanë rrugë tjetër vetëm se të vihen në shërbim të faktorëve institucionalë, shkencorë dhe kulturorë, që gjer më tash përjashtimin e alternativave e kanë pasur si tipar thelbësor. Pra, mungesa e vizionit dhe transparencës së veprimeve të domos-

doshme, nëpër institucionet e qeverisshme dhe të paqeverisshme, për shkrimin apo rishkrimin e historisë së letërsisë, lë shtigjet hapur për hamendje dhe mëdyshje, letrare dhe jashtëletrare, edhe në këtë sipërmarrje të domosdoshme dhe jetëdhënëse, nëse do të vijohet të shkruhet dhe shqyrtohet letrarja, në këtë nalinë tonë. Mirëkuptimi dhe bashkëveprimi, nëse do të gjendet një mundësi e këtrillë, që siguron marrëdhënien e ndërsjellë, kurrsesi nuk do të thotë "nënshtrim" i dyanshëm, jashtë rregullave dhe kodekseve shkencore.

Së treti: Kush mundet që ta shkruajë historinë e letërsisë? Në praktikën e shkrimit të saj, në letrat shqipe, kryesisht për nevojat e shkolimit dhe të njohjes së letërsisë sonë, ka ngjarë që historia e letërsisë të shkruhet edhe nga individ të veçantë, vendas apo të huaj. Kështu ka ngjarë me historinë e popullit, gjuhës dhe letërsisë shqipe, në italisht, nga italo-arbëreshi **Gaetano Petrotta**, qysh në vitin 1932, një tekst që ende vijnë që të mos jetë botuar në gjuhën shqipe, për arsye e mosarsyes së "herolikës" letrare shqiptare, ndonëse më në fund është përkthyer. Mbase, do të vijojë edhe për disa vite situata e vjeljes pa e ciptuar fare, siç edhe ka ngjarë nëpër këtë 76 vite. Po ashtu, ka ndodhur edhe me tekstin e "Historisë së Letërsisë Shqipe" të **Robert Elsie**s, në vitin 1997, por edhe të një varianti më të shkurtuar në vitin 2005, në shqip dhe anglisht. Historia e Letërsisë shqipe është botuar edhe nga Akademiti e Shqipërisë dhe Kosovës, në shërbesë të shkallave të niveleve të ndryshme arsimore. Për shtetin amë, siç edhe thirret ndonjëherë Shqipëria, libri i fundit për Historinë e Letërsisë shqipe është botuar në vitin 1983. Ky tekst, në një kuptim të

ngushtë, një pjesë të konsiderueshme të autorëve dhe teksteve të përjashtonte, kurse një masë tjetër të madhe të autorëve dhe teksteve i lexonte me kufizime ideore, tashmë është i tejkaluar. Mirëpo, në hapësirën më të gjerë të mundshme, pra në kuptimin e kundërim-it të letërsisë shqipe deri në vitin 1939, libri akademik, duke ia hequr vëllonë ideologjike dhe sociologjike, shtrënguese dhe përjashtuese, edhe mund të ruhen dhe të shërbejnë të dhënat biografike mbi autorët dhe periudhat, si dhe shqyrtimet mbi rrymat, drejtimet dhe format e shprehësisë poetike, të cilat janë përfundime të leximit dhe shqyrtimit të teksteve të etapave të ndryshme letrare. Pra, ai tekst nga libër i përjashtimit të jo pak alternativave, autorëve dhe teksteve, nëse përpunohet dhe rishkruhet, në parametra letrarë dhe shkencorë, edhe mund të shërbejë si shtrat i shkrimit dhe rishkrimit të historisë së vërtetë të letërsisë shqipe, natyrisht duke bërë ndarjen e letrares prej jashtëletrares.

Së katërti: Letërsia bashkëkohore, ku bën pjesë qoftë modeli zyrtar i Realizmit Socialist, me **Kadarenë, Agollin, Qosen, Xoxen, Arapin** etj., me tekstet e shërbesë dhe të dyzimit letrar, pra edhe me vlera të njëmendta letrare, për secilin prej këtyre autorëve. Në letërsinë bashkëkohore shqipe, duhet që të përfshihen autorët e diasporës së vonë, **A. Pipa, M. Camaj**, për vlerat e teksteve letrare, në poezi, prozë, dramatikë dhe studimet letrare dhe gjuhësore. Pjesë

e letërsisë shqipe bashkëkohore është edhe modeli antizyrtar, shpesh i emërtuar si disidencë, me **Z. Zorbën, K. Trebeshinën, B. Xhaferrin, F. Reshpen** etj., grupim që arriti që ta sendërtojë letraren në poezi, prozë, dramatikë me një poetikë të veçantë. Po ashtu, letërsia bashkëkohore, nuk mundet që të kuptohet pa vlerat letrare të letërsisë së trojeve etnike, ku përfshihen **A. Pashku**, në prozë dhe dramatikë, **A. Shkreli, F. Gunga, Rr. Dedaj, B. Musliu, A. Podrimja**, në poezi etj.

Anashkalimi i këtyre çështjeve parimore, jetike për shkrimin e një historie vlerash letrare, e cila duhet të shmangë estetikën e refuzimit estetik, po ashtu edhe vlerën e hierarkisë letrare, si dy prej "**rran-gullinave**" të botës që lamë pas, vështirë se do të mbërrihet në këtë lartësinim. Megjithatë, midis këtyre aspekteve, *nyja gordiane*, ku edhe përplasen interesat dhe egjozmat e tanishëm, krahinore dhe provinciale, fetare dhe antifetare, letrare dhe pushtetnare, qeverisëse dhe opozitare, se ç' lidhje kanë rrafshet jashtëletrare hajde e merre vesh, të synimeve, klaneve dhe të konceptimeve të ngushta, madje edhe gjurma thelbësore e përjashtimit të mënyrave të ndryshme shkrimore, është letërsia bashkëkohore. Termi letërsi bashkëkohore, sipas optikës së shkencës letrare, ndonëse jo pak titujmbajtës të saj, hedhin shashka se ajo, pothuajse nuk është fare, përfshin të gjitha modelat letrare, zyrtare dhe antizyrtare, etnike dhe të diasporës. Letërsia bashkëkohore, tashmë duhet vështuar dhe verifikuar në vlerat dhe shenjat letrare, si dhe duke shmangur praninë e refuzimit estetik në secilin alternativ të shpërfuar, të pandashëm në letrat shqipe. Rreka mjerrane, e gjer më tash vetëm e pëshpëritur nën zë, për të kundruar dhe shqyrtuar si letërsi bashkëkohore vetëm autorët dhe librat e botuara rreth dhe pas viteve '90', të cilët rezultojnë edhe çmim-fituesit më të mëdhenj të kësaj kohe, të mbushur me mediokritet letrar, fsheh dhe zbulon pikësynimin që këta fitimtarë të çmimeve të lëshuara, me shumë shoqëritë dhe politikisht se sa artistikisht, të strehohen në Historinë e Letërsisë, në tërësinë e vlerave gjithkohore dhe gjithhapësinore. Gjasat janë që të ndodhë pikërisht kështu, sepse ngasa është bërë publike prej institucioneve, kinse hartuese të Historisë së Letërsisë, ku po mbizotërojnë termat: letërsi e ndalur, letërsi e burgut, letërsi antikomuniste, të cilat në thelb, ka pak gjasa që merren me letraren dhe shprehësinë që realizojnë ajo, dhe vetëm sa realizojnë përmbysjen e letërsisë së re, e letërsisë së shërbesës, e letërsisë së Realizmit Socialist, çka do të sugjeronte një tipologji tjetër verifikimi, si model i "Realizmit Demokratik", ku "gardistët e kuq", tashmë janë zëvendësuar me "gardistët blu" ose të çfarëdo ngjyrese tjetër. Ky nxitim, krejt i habitshëm dhe mendjemarrës, i shkencëtarëve, me kontribute letrare dhe shkencore, por edhe me kontribute partiake dhe qeverisëse, do të thellonte përjashtimin që e kreu me sukses Socrealizmi, pak vite më

SCili është roli i mjedisve institucionale dhe i atyre individuale, në procesin e shkrimit të historisë së letërsisë shqipe? Më e mira do të ishte që këto dy faktorë të rëndësishëm, të ishin në bashkëveprim dhe mirëkuptim të ndërmjetshëm.

Mpl#**Q**
Vtl#**sul**#**w**#**q**#**v**#**h**
kdump#**n**o#**w**#**u**#**h**#**kd**#**/**
g#**h**#**h**#**w**#**u**#**u**#**h**#**j**#**o**
h#**s**#**d**#**n**#**u**#**/**#**w**#**k**#**p**#**s**#**i**#**n**#**d**
l#**q**#**w**#**l**#**h**#**g**#**h**#**n**#**/**#**u**#**h**#**h**#**h**#**w**
n#**h**#**l**#**g**#**h**#**w**#**y**#**d**#**w**
s#**d**#**x**#**g**#**g**#**h**#**w**#**h**#**h**#**n**#**t**#**h**#**w**#**q**#**d**
x#**g**#**k**#**n**#**u**#**d**#**h**#**o**#**w**#**d**#**w**#**l**#**d**
h#**h**#**h**#**w**#**u**#**h**#**q**#**h**#**w**#**h**#**n**#**o**#**w**#**#**#**n**#**k**#**o**#
h#**h**#**h**#**w**#**h**#**h**#**w**#**q**#**h**#**w**#**k**#**o**#
l#**q**#**w**#**l**#**h**#**g**#**h**#**n**#**/**#**u**#**h**#**h**#**w**#**#**#
s#**u**#**m**#**n**#**w**#**l**#**g**#**h**#**w**#**h**#**g**#**h**#**l**#**o**#**/**#**h**
w#**g**#**h**#**w**#**h**#**w**#**#**

toll, gjëmoi dhe më pas u ngrys. Ish-te këshilltari dhe shok i Muhamedit, po jo shok e mik me gratë. "Pashë Allahun, ku ishte? Pse ishte vetëm me atë burrë që s'është i yti?". Akuzat e tij më fshikulluan si era që hyn përmes turmës dhe lëshon shkëndija në flakë.

"Al-zaniya!" qau prapë dikush. Belbëzoja sikur në vend të fjalëve do hidhja gurë.....

...Muhamedi më shtyu drejt hyrjes së xhamisë. Si në një mozaik fytyrat e tyre sillleshin para meje: Hamali lëkurëtrashë dhe gruaja e tij e zbehtë Fazia, tashmë quhet Jamila, gërthisnin dhe nxiheshin, llafazani i qytetit, Umm Ayman, shtrëngonte buzët e rrudhura, Abu Ramzi, argjendari tundte grushtin teksa i dukeshin unazat e arta. I prisja thashethemet kur do kthehesha, dhe të heqja vetullat, por kjo? Njerëzit që më njihnin që kur kisha lindur tani donin të më ndanin copash. Po Safuani? - ktheva kokën për ta parë, por ishte zhdukur. Si gjithmonë. Gishta të vrazhdë m'i shkulën flokët. Bërtita dhe i shtyva, po një lumë pësh-tyme m'u hodh në krah. Muhamedi më la në këmbë dhe iu kthye turmës pastaj ngriti dorën lart. Hesh-tja ra si qefini, myfitë madje dhe shkëlqimi.

"Aishes i duhet të pushojë", - tha Muhamedi. Zërin e kishte të lodhur me sa e kuptova. "Ju lutem ktheju-ni në shtëpi".

Ai më shtrëngoi me krahë dhe hymë në xhami. Motrat e mia-gratë ndenjen pranë hyrjes së kopshtit, dy nga dy. Sawdah erdhi me vrap, ulërinte, më rrokua me krahët e vishkët. Iu lut Allahut për kthimin tim, puthi hajmalinë e saj për të më larguar syrin e drejt. Pastaj erdhi Hafsa, qante, m'i puthte duart dhe faqet. Pëshpëriu, "mendova se ike përgjithmonë". S'mund t'i thosha se gati kishte të drejtë. Umm Salama tundte kokën, nuk e bënte buzën në gaz, sikur të kishte frikë se koka mund t'i binte nga qafa e

saj e gjatë. Zainab e shihte sh-trembër Muhamedin sikur të ishin vetëm ata të dy në dhomë. Por shqetësimet e tij ishin vetëm për mua. Kur stomaku më shtrëngoi sërish, e isha duke u rrëzuar nga dhimbja, ai më kapi dhe më ngrii aq lehtë sikur të isha prej ajri. E në të vërtetë, kisha lënë pak gjë brenda meje. Notoja në krahët e tij në apartamentin tim. Ai e shkelmoi derën për ta hapur dhe më futi brenda, më uli sërish ndërsa rregullonte shtrat-in. U mbështeta pas muri, e kënaqur nga qetësia - deri sa të bërtiturat e Umarit hynë në dhomë, i ndjekur nga vetë ai....

...."Të lutem Umar", - tha Muhamedi. "A nuk e sheh se është e sëmurë?"

"Po e llaston."

"Jam i lumtur që e shoh të gjallë, falë Allahut." Dashuria në sytë e tim shoqi më bëri të skuqem. Si mund ta tradhetoja me atë mashtrues. Safuani më joshi me liri, pastaj e lidhi fa-tin tim me dëshirat që kishte. Aspak ndryshe nga burrat e tjerë.

Ndoshta, përveç, Muhamedit.

"Yaa habibati, çfarë shpërbli-mi mund t'i jap Safuanit ibn al Mu'attal që të sollti gjallë në shtë-pi, pranë meje?"

"Një qind kamxhikë besoj se mjaftojnë," më merrti Umar.

"Po Safuani i shpëtoi jetën."

"Duket që Umar mendon se duhej të kisha mbetur në mëshirën e çakejve apo bedu-inave", - thashë.

"Të paktën do vdisja me ndër të paprekur."

"S'ka ndodhur asgjë me nderin e Aishes", - tha Muhame-di.

"Thuaja Hasan ibn Thabitit", - tha Umar. "E dëgjova qëparë që recitonte peozë për gruan tënde dhe atë ushtarin që shkon pas femrave."

Një peozë. Nuk habitem që uma të më ketë ndjekur pas si një tufë gjenjsh kur iga nga qyteti. Fjalët e Hasanit ndërsejnë aq shumë turmat në atë farë urre-tjeje aq shpejt sa dhe duart e n-gritura të Muhamedit mund ta shtypin atë. Po nuk doja që Umar të më shihte tek dridhesha. "Unë, me Safuanin? Është qesharake", thashë. "Jam gruaja të të shen-jtit Profet të Allahut. A ka mundësi të dua dikë tjetër veç atij?"

E ndjeva se Muhamedi po më shikonte. Nxehtësia m'u përhap si flakë në lëkurë. A mos e kupt-oi gënjeshtrën që qendronte pas buzëqeshjes sime? Hapa të she-pjetë u dëgjuan në gurët e oborrit. Dora e një burri shtyu derën e hapur të apartamentit. Unaza e tij e argjendtë shkëlqeu si maja e shpatës: Aliu, kushëri i Muha-medit, i cili e kishte adoptuar por njëkohësisht edhe dhëndër...

Shënimi
Ky fragment është shkëputur nga prologu i romanit "Xhevahiri i Medinës" me titull "I vetmi gisht tregues". Nga kjo pjesë janë hequr dy tre pasazhe që mund të fyejnë personazhet e botës Islame.



“Vargjet satanike”

SALMAN RUSHDIE

Të lindësh përsëri”, këndonte Xhibrieli Farishta ndërsa binte nga qiejt, “më parë duhet të vdesësh. Hej e! Hej e! Më parë duhet të dish të fluturosh pastaj të ngrihesh nga zemra e tokës. Tat-taa! Taka-tun! Si do të qeshësh, nëse më parë nuk qan? Si do ta fitosh dashurinë e mistershme të së dashurës, pa psherëtirë? Baba, nëse do të që lindesh prapë...”. Pak para se të perëndonte mëngjesi i një dimri, diku andej nga Dita e Vitit të Ri, dy njerëz, të rritur, njerëz të gjallë, ranë nga një lartësi e madhe, njëzet e nëntë mijë e dy këmbë, drejt e në Kanalin Anglez, pa ndonjë ndihmë, parashutë apo krahë, ranë nga qielli i pastër.

“Po ta përsëris, duhet të vdesësh, kështu të them” dhe kështu dhe kaq poshtë hëna prej alabastre përshkoi natën deri në vajtim. “Djali më meloditë e tua”, fjalët janë si kristalina në të bardhën dhe të akulltën natë, “në filma ju doni t’i dëgjoni këngëtarët, por po më shqetësojnë shumë tani këto zhurma të tmerrshme.”

Xhibrieli, solisti i parë, kërcëru në dritën e hënës dhe këndoi poezinë e sapokrijuar, notonte në ajër me stilin futur, pastaj me atë të bretkosës, e mblidhte veten si top, shtrinte krahët drejt gati pafundësisë, gati drejt perëndimit, qëndronte si heraldik, i tërbuar, shtrirë, vinte kundër njëra-tjetrës mendjelehtësinë dhe gravitetin. Tani mbështillet i lumtur dhe këndon me zë të hidhur: “Oh, baba Salad, ti je, shumë mirë. Çfarë kemi, plaku Shumsh”. Për të, tjetri, është hije e bezdisshme që bie shpejt, hija është e veshur me kostum gri me kopsat e xhakëtës të zbër-thyera, me duart rreth vetes, pranon se e ka të pamundur të vërë kapele republika, prandaj e thërret me emër të tillë. “Hej Leshko”, çirret Xhibri-eli, dhe vendos të zbrapset për së dyti, “Brenda në Londër, bah! Ja ku jemi! Maskarenjtë nuk duan ta dinë se çfarë i goditi. Meteori, vetëtima apo hakmarrja e Zotit. Jashtë në ajër të pastër, e dashur: Bam! Bram bam bababam? Çfarë hyrjeje, dreqin. Be-tohem: shpinë”.

Jashtë pa lënë gjurmë: zhurma e madhe ndiqet nga rënia e yjeve. Filli-

mi i përbotshëm, jehonë e vogël e lindjes së kohës...reaktivi vigan Bostan, Fluturimi AI-420, u nda me mijëra pa paralajmërim, atje lart në qiell, i kalbur, i bukur, i bardhë borë, qytet i ndriçuar Mahagonia, Babilonia, Alfavila. Por Xhibrieli i kishte vënë emrin, nuk duhet ndërhyrë: Brenda në Londër, kryeqyteti i vila-jetit, puliti dhe i picërroj sytë në natë. Ndërsa në lartësitë e Himalajave shpërthimi i parakohshëm dhe i sh-kurtër i diellit në ajrin e pluhurosh të janarit ishte një pikë që u zhduk nga ekranet e radarëve dhe ajri i pastër ishte plot me trupa, duke zbrit-ur nga katastrofa e Everestit të zbe-htësia e bardhë e detit.

Kush jam?
Kush është tjetër?
Aeroplani u nda përgjysëm, fara e bishtajës sapo nxori kokën nga toka, veza i nënshtrohet misterit të saj. Dy aktorët, mendjemadhi dhe i mbërthyeri Xhibrieli dhe zoti Saladin Shamsa, nuhatën erën e duhanit nga një cigare e vjetër. Sipër, prapa, poshtë tyre në boshllëk atje binin karriget, kuljet e stereofon-ikëve, tryezat e pijeve, kontenierët, biletat e zbritjes, videot për lojra të blera në dyqanet pa doganë, kapele të thurura, letra filxhanësh, batanije, maska oksigjeni.

Në avion gjithashtu kishte emi-grantë, një numër i madh gra të pjekura në mënyrë e duhur, e kish-in kryer detyrën e tyre për të matu-ar gjatësinë dhe për të dalluar nis-hanet mbi organet gjentiale të bur-

rave, në avion kishte dhe fëmijë, mbi numrin e ligjshmërinë e të cilëve I pati llogaritur dyshimet e saj qever-ia britanike - të gjithë këta u për-zien me tepricat e aeroplanit, të copë-tuara në mënyrë të barabartë, një-l-voj absurde, fluturuan copëzat e shpirtit, kujtime të harruara, ndërgjegjet e flakura, gjuhë të ash-p-ra, intimitetet e dhunuara, shaka të pakuptueshme, ardhmëri të shua-rra, dashuri të humbura, kujtime të harruara të boshit, fjalë buçitëse, tokë, që i përket, shtëpi. Një budal-ka kërciti nga rryma e ajrit, Xhibri-eli dhe Saladin duken si pako të hedhura pa kujdes dhe si të kapur nga një sqep lejkuku, dukej kështu sepse Shamsa po binte me kokën përpara, një pozicion i preferuar për foshnjat kur dalin nga kanali i lindjes, ai filloi të acarohet pasi tjetri s'pranonte të binte me stilin e du-hur: Saladin binte pikiatë ndërsa Farishta përqafohte ajrin, duke e rrruar me këmbë e duar, një aktor shumë i lodhur dhe pa ndonjë tekni-kë që të përmbahej.


Poshtë, në masën e madhe të rëve, duke pritur hyrjen e tyre, u mpiks ngadalë rryma e Mëngës An-gleze, zonë e shënuar për ri-mishërimin e tyre të ushë.

“O, këpuçet e mia janë japoneze”, këndoi Xhibrieli, duke përkthyer një këngë të vjetër në anglisht me një zërin e njeriu që kërkon të sulmojë kështu kombin mikpritës.

“Pantallonat janë angleze, nëse doni. Në kokë kam kapele ruse; por zemrën indiane e kam të tërën”. Retë lëviznin drejt tyre, dhe ndosh-ta kështu ndodhte për shkak të mis-tifikimit të madh të tyre dhe të bre-rorëve, lëkundjet e fuqishme të bubullimave u rrinë si cëkanë perëndimit, ose ndoshta ishte këng-a (njeri është i zënë me shfaqjen, tjetri i fishkëllen asa), ose kllapia e shkullmit të erës që ruan për ta njo-huri të plota për atë që do të vijë...por për çdo lloj arsyeje, dy bur-rat, Xhibrielsaladin Farishtasham-sha, të dënuar për këtë

pafundësi, por gjithashtu duke i dhënë fund rënies engjëllorëdjallë-zore, nuk u bënë të vetdijshëm për momentin se kur filloi procesi i shndërrimit të tyre.

Ndryshim?




L

VITRINA E LIBRIT

Ditë të qeta në Klishi
Autori: Henri Miller
Përktheu: Elvana Zaimi
Lloji: Roman
Botues: Koha Ditore
Faqe: 98

Romani biografik "Ditë të qeta në Klishi" është një vepër theblësore dhe shprehëse e karakterit të shkrimtarit amerikan Henry Miller, i cili njihet për përzierjen e seksit me filozofinë si dhe është një vepër informuese për kohën në të cilën ai jetoi. Ai është shkrimtari i romaneve që u ndaluan për shumë vite nga publikimi dhe qarkulli mi në SHBA dhe që vuri para sprovës ligjet federale përballë artit dhe pornografisë. Libri është një pasqyrë e ditëve që autori kaloi në Paris në vitet '30. Mënyra e hapur e diskutimit të tij për seksin bëri që romani të qarkullonte në Francë dhe shumë vite të tjera shumë më herët sesa të botohet në vendlindjen e autorit. Botimi i parë i kësaj kryevepre në SHBA u bë i mundur vetëm në vitin 1961. Romani është përshatuar edhe për disa filma të suksesshëm.



Jeta pasionante e Mopasanit
Autori: Stephen Coulter
Përktheu: Sonila Meksi
Botues: Ideart
Faqe: 392

Mopasani dehej nga vera e jetës. Ai ndjente brenda tij një dashuri kafshërore dhe e thellë, mëshirëplotë dhe e shenjtë për gjithçka që jetonte, që rritej, për gjithçka që ishte një krijesë në sytë e të gjallëve. Dashuria dhe çmenduria kishin qenë temat kryesore të jetës së tij. U varros pa arkivol në varrezat e Monparnasit. Kishte shprehur dëshirën që të varrosej rrafsh në atë tokë që e kishte ushqyer; ajo u plotësua. Ndërmjet atyre që nderonin për herë të fundit eshtrat e tij, ishin edhe dy gra që ai i kishte dashur: Hermina dhe Klemi. Ato u larguan, të heshtura dhe të kapura dorë për dorë



B

BIBLIOTEKE

"Historia e Shqipërisë dhe e familjes së saj Mbretërore 1443-2007", e Patric Najbor është një vepër, në të cilën ai përpigjet të vendosë të vërtetën historike duke paraqitur me objektivitet, [http://www.koha.com](#)



Patric NAJBOR

Kam rishkruar historinë e Shqipërisë

ADMIRINA PEÇI

Patric Najbor, doktor i shkencave politike dhe studiues francez i historisë mendon se Esat Pashë Toptani kishte një strategji të tijen kur e dorëzoi Shkodrën dhe u tërhoq bashkë me ushtrinë e tij nga qyteti, duke ua lënë atë në dorë malazezve. Sipas tij ai u tregua jo tradhëtar, por largpamës dhe i shkathët, meqenëse disa ditë më vonë nën presionin e Fuqive të Medha, mbreti Nikolla i Malit të Zi, u detyrua ta kthente qytetin.

Në të vërtetë kjo është vetëm një linjë në librin e tij studimor "Historia e Shqipërisë dhe e familjes së saj Mbretërore 1443-2007", vepër në të cilën ai përpigjet të vendosë të vërtetën historike duke paraqitur me objektivitet, veçanërisht në saj të burimeve të jashtme faktet dhe personat, të cilët nuk janë njohur deri tani nga historiografia shqiptare. Ai thotë se "në mënyrë modeste jam munduar të sjell një kontribut në rishikimin e historisë së Shqipërisë", aq i debatuar këto kohë. Libri i cili është botuar në Francë para pak ditësh, është i ndarë në pesë vëllime. Në vëllimin e parë autori është përqendruar kryesisht në luftën për pavarësi që zë vendin kryesor dhe për këtë ai ka studiuar vepërimet e Fuqive të Medha për të ruajtur ose zgjeruar sferat e tyre të influencës, si dhe rolin e tyre në zgjedhjen e princit Vilhelm Wied (1914). Po në këtë vëllim ai trajton edhe personazhin e Esat Pashë Toptanit, ku ndër të tjera shkruan: "Me shpalljen e Luftës së Parë Botërore, Esat Pasha u rreshtua menjëherë në anën e Aleatëve në krah të të cileve ai luftoi dhe nga ana tjetër duke pranuar që ushtria serbe e dërmuar nga lufta të terhiqej duke kaluar nëpër Shqipëri ai shpëtoi Frontin e lindjes si dhe vendosi Shqipërinë në kampin e fitimtarëve".

BIOGRAFIA E AUTORIT

Dr. Patrice Najbor është diplomuar në Institutin e Studimeve të Mardhënieve Ndërkombëtare (ILERI) të Parisit, titullar i një diplome të studimeve të larta të specializuara (DESS) të diplomacisë dhe administrimit të organizatave ndërkombëtare, doktor i shkencave politike. Ai ka realizuar një tezë mbi "Dykrënjat e Shqipërisë në mardhënie ndërkombëtare bashkëkohore" (Paris XI - 1992) dhe shumë shkrime në kuadër të një diplome të studimeve të thelluara (DEA) të mbrojtjes dhe sigurimit evropian (Lille II - 1990) midis të cilëve "Sistemi dhe politika e sigurimit të Shqipërisë" dhe "Çështja shqiptare e Kosovës". Ai është autor i "Dinastisë së Zogut" 2002 dhe i "Historisë së Shqipërisë dhe e familjes së saj mbretërore 1443-2007" në pesë vëllime 2008.



Fan Noli dhe Ahmet Zogu

Në vëllimin e dytë të librit, autori paraqet periudhën e viteve njëzetë duke sjellë, sidomos, një veshtirim të ri persa i perket figurave të Fan Nolit dhe Ahmet Zogut.

"Në kundërshtim me atë që për shumë kohë është folur; Fan Noli, ishte larg të qenurit demokrat meqenëse qeveria e tij bolshevike eci drejt diktaturës duke shpallur në të gjithë vendin gjendjen e shtetërrehtimit, duke vendosur gjykatat e jashtëzakonshme dhe duke mos mbajtur premtimin e tij për të organizuar zgjedhjet.

Fan Noli nga ana tjetër thoshte se "demokracia është një komedi hipokrite, parlamenti një morg, dhe zgjedhjet e lira një komedi e vertete". Logjikisht meqenëse Fan Noli ishte, si mbas "historisë zyrtare", demokrat, Ahmet Zogu duhej të ishte diktator në një kohë kur ai ishte një personalitet në ngjitje i kësaj periudhe meqenëse ka qenë me radhë ministër i mbrendshëm, kryeministër, dhe pastaj President i Republikës, para se të bëhej mbret e që do të mund të fliste në emer të

të gjithë shqiptarëve, territori i të cilëve kishte qenë cunuar me 2/3 nga Konferenca e Ambasadorëve mbledhur në Londer më 29.07.1913..."

Sipas Patric Najbor, "studimi i periudhës zogiste tregon se mbreti Zog me realizimet e tij në fushat institucionale, legjislative, edukative, shëndetësore, ushtarake, diplomatike, ekonomike dhe në drejtim të zhvillimit të ndërtimit të rrugëve dhe të infrastrukturës së vendit ka vendosur bazat e një shteti modern, demokratik të tipit perendimor dhe duke zëvendësuar të drejtën e forcës me forcën e të drejtës, ai paraqitet si njeriu më progresist i kohës. "Ataturku shqiptar" i vetëtë shfuqizoi feudalizmin, dekretoi shtetin laik dhe kontribuoi në zhvillimin e ligjit per vendin e gruas në shoqërinë shqiptare".

Përpjekjet e mbretit Leka I

Në vëllimin e tretë Najbor përpjket të tregojë udhëtimin e gjate e të vështirë të familjes mbretërore në mërgim dhe luftën e vazhdueshme të mbretit Leka I për çlirimin e Shqipërisë nga komunizmi dhe të Kosovës nga zgjedha Serbe.

Najbor na sjell për këte problem në vëllimin e pestë edhe shumë dokumenta, shpesh të panjohur, të veprimëve të ndryshme politike të mbretit Leka. "Mund të themi se përtje mosmarrëveshjeve të shqiptarëve të diasporës, mbreti Leka ka punuar per ribashkimin e kombit shqiptar", shkruan Najbor. Më tej në këtë vëllim autori tregon se si Princi trashëgimtar Leka II është përgatitur për t'i shërbyer vendit të tij.

Kthimi i familjes mbretërore Në vëllimin e katërt Najbor tregon kthimin e familjes mbretërore në Shqipëri dhe rrethanat politike të viteve 2000 si në Shqipëri ashtu edhe në rajon. Këto rrethana sollën pas një rruge të gjatë pavarësinë e Malit të Zi 03.06.2006 pastaj të Kosovës 17.02.2008, kthimin në pushtet të Sali Berisheshës 03.09.2005 dhe tranzicionin e gjatë e të vështirë demokratik, marrjen të pandehur të Ramush Haradinaj 07.03.2005, miratimin nga parlamenti të ligjit për familjen mbretërore 08.05.2003, kthimin e pallatit të princeshave 05.11.2005, nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Bashkimit 12.06.2006, si dhe vdekjen e presidentit Ibrahim Rugova 22.01.2006 dhe të mbretëreshave Geraldinë 22.10.2002 dhe Suzan 17.07.2004.

Dokumnteta nga arkivat

Vëllimi i pestë i këtij libri përmban dokumenta të arkivave, të traktateve ndërkombëtare dhe të marrëveshjeve sekrete, të letrave dhe pemëve gjeologjike. Duke botuar këto tekste origjinale në tërësinë e tyre, najbor tregon më shumë se permendjen e thjeshtë të tyre, me qellim që lexuesi të ketë mundësi vetë të shprehë mendimin e tij mbi faktet e treguara. Libri përfundon me një bibliografi të pasur të veprave të shekullit të XV e deri në ditët tona.

Ky libër, që nga koha e botimit të parë e deri më sot, është ribotuar pafundësisht.



“GRA TË VOGLA”, libri i të gjithë KOHRAVE

Një nga librat më të bukur të të gjitha kohërave “Gra të vogla” është më shumë se kaq: një libër i pavdekshëm. Ky libër, që nga koha e botimit të parë e deri më sot, është ribotuar pafundësisht. Pasi të lexohet është e pamundur të harrohet. Në “Gra të vogla”, Ellkot na tregon krijimin e saj më të mirë, por në të njëjtën kohë edhe nga më të mirët e të gjitha kohërave. Jeta e përditshme e motrave Març, nëpërmjet gëzimeve, keqkuptimeve dhe dashurive të para, ka mrekulluar dhe vazhdon të mrekullojë lexuesit e të gjithë botës. Libri flet për jetën dhe dashuritë e katër motrave që u rritën gjatë luftës Civile Amerikane. Romani u bazua në eksperiencën e vetë autores, e cila e kaloi fëmijërinë në Germantown të Pensilvanisë me tre motrat e saj, Anna, May dhe Elizabeth.

E dashura Beti, e talentuara Xho, e brishta Megi, ngacmuesja Eml, këto janë katër motrat Març. Përmes ëndrrave të tyre, gratë e të gjitha moshave janë bërë pjesë e kësaj familjeje të pakrahueshme dhe janë ndër thellësisht të kënaqura, kur Megi shkëputet nga rrethi i



Autori: Luiza Mei Ellkot
Përkthues: Guri Shtyri
Lloji: Roman
Botues: OMSCA-1
Faqe: 334


motrave për të filluar një jetë të re...

Pa asnjë dyshim, “Gratë e Vogla” mbetet vepra më e mirënjohur e Louisa May Alcott. Sharmi dhe pafajësia vijon të tërheqë lexuesit, pavarësisht faktit se realiteti shoqëror dhe familjar i përshkruar në roman është shumë shumë i ndryshëm nga jeta familjare e ditëve tona. Xho Març shikohet si një nga personazhet më të kompletuar dhe më i dashuri personazh në letërsinë për fëmijë. Në fakt, shumë djem ndjehen mirë kur e lexojnë librin po aq sa edhe vajzat. Ndërsa lexuesit e ditëve tona shpesh e gjejnë këtë personazh tepër të mirë për të qenë e vërtetë, sipas standardeve të shoqërisë së kohës së autores, vajzat e familjes March janë të brishta. Autorja tentoi t’u jepte personazheve të veta një dozë egoizmi, vaniteti, inati dhe turpi, cilësi që nuk qenë parë kurrë më herët në personazhe të tilla për fëmijë. Alcott e shkruajti librin për vajza me qëllimin e vetëm për të fituar para. Kur pjesa e parë u publikua si një vepër e përfunduar, lexuesit kërkuan të dinë më shumë mbi fatet e vajzave të familjes March. Alcott shkroi “Gratë e Mira”, e cila tashmë publikohet brenda pjesës së parë. Megjithëse autorja e shkroi librin si pa dëshirë, ajo krijoi një personazh që hyri në jetën e fëmijëve të shumë brezave.

VITRINA E LIBRIT

Djali në trup
Autori: Raymond Radiguet
Lloji: Roman
Përkthues: Nasi Lera
Botues: Albin
Faqe: 152

Një meteor në letërsinë franceze të shek XX, i cilësuar nga kritika "një gjenie i parakohshëm", "një çudi" Mik i Rembosë, arriti të shkruajë dy romane, njeri nga të cilët "Djali në trup" ku të rrëmben analiza psikologjike e dashurisë së një të riu.



"E kuqja është blu"
Autori: Edoardo Sanguineti
Përkthues: Silvana Leka
Lloji: Poezi
Botues: Ideart
Faqe: 88

Edoardo Sanguineti është një nga emblemat e poezisë dhe kulturës jo vetëm të neomodernitetit italian, por edhe më gjerë. Ai është poet i përtej avangardës, kulturolog i shumëfishit dhe autor i një serie teksteve poetike, narrative e teatrale, i mjaft studimeve kritike, eseve dhe komenteve letrare e kulturologjike, siç janë ato mbi Danten, Paskolin, etj.



Gjithë shpirtat
Autori: Javier Marias
Përkthues: Shpëtim Doda
Lloji: Roman
Botues: Ideart
Faqe: 272

"Javier Marias ka një talent të jashtëzakonshëm, proza e tij arrin të ndërlihdë në mënyrë mahnitëse ironinë filozofike me dhembshurinë që përlindet prej qenies sonë të rrëgjosur, prej impulsiveve që na shtynjë drejt vetëshkatërrimit."



Su Artistin

Sytë e tij të gjallë e të zinj dalin nga ekrani sa herë lipset ta kujtojmë dhe me heshhtjen e tij duket sikur na nënërit në vesh këto fjalë: **Plt#w#l/#pog#w#w#u#j#w#n#n#w#d#k#k#t#u#v/#pog#w#w#u#j#w#n#k#n#w/#pog#w#w#d#u#n#g#g#k#w#d#i#p#w#s#k#q#j#n#q#n#d#u#q#g#n#w#u#j#w#g#n#w#u#s#q#g#k#w#d#q#l#w#s**

KIÇO BLUSHI

Nuk e dija që do të ishte kaq e vështirë të hidhja në letër disa rreshta për shokun tim të fëmijërisë e rinisë, Vangjush Furxhiu. Për një aktor të madh, për një artist të përmasave të Vangjushit, duket sikur është e lehtë të kujtosh, të rrefesh, të vlerësohesh e të çmosh një artist me një shkrim që lipset për të përcjellë një libër të tij me studime të pabotuara... Ka artistë e aktorë të tjerë, që i njoh e i vlerësoj më pak, a ndoshta më shumë e që do t'a kisha ku e ku më të lehtë të shkruaja in memoriam disa fjalë në nderim e në kujtim të tyre...

Ndoshta është modestia e lindur të Vangjushi, një modesti dhe thjeshtësi e tij gati-gati gjenetike, (veti kjo fort e rrallë sidomos te aktorët të bërë me famë për së gjalli) që ndoshta më jep pak lëndë e ca më pak mundësi të flas për të, ndonëse në mungesë të tij, si për një artist përnjohim të madh, të cilin nuk e mbulon dot as harresa dhe as mopëfillja e mizores Kohë...

I ndjej sytë e butë të tij që do të më qortonin, po t'a lavdëroj me të drejtë, natyrisht pa i ngrënë hakun... Ai nuk do ta pranonte këtë dhe jo vetëm unë po edhe miq të tjerë të tij nuk do të guxonin t'a lavdëronin në sy... Sepse atij nuk i pëlqenin lavdet, mburrjet, pozat prej të "madhi"; Vangjushi skuqej, turpërohej si një fëmijë e ndoshta është aktori i vetëm i skenës dhe i ekranit që në jetë ishte aq i turpshëm, aq i ndrojtur; aq i thjeshtë, aq modest, ndërsa në skenë aq i qashtë dhe kryekrejt i papërsëritshëm e origjinal; atij i vinte turp e ndot prej falcitetit e pozave, prej shtinjakëve dhe mburacakëve që sot rrëmbushin aq rrëndom mjediset artistike nga që e ngjitin si pa gjë të keq surratin në tregun e reklamës, që talentin e servirin mbi tryezën e favoreve, që smirën dhe zilinë i hipin nëpër podiume, që karakterin e shesin për çmime të pamëruara, duke pandehur se kjo është fama e vërtetë, përjetësia që synon akti i krijimit.

Vangjush Furxhiu ishte ngjizur me tjetër frymë. Ai është ndoshta fisniku i fundit i skenës dhe jo vetëm i artit. Ai asnjëherë nuk e vuri kontributin e vet artistik dhe punën e çmuar si pedagog në Akademinë e Arteve në disproporcion të zhdrejtë me snobizmin karakteristik të aktorëve provincialë që emërohen në kryeqytet e bash për këtë arsye tjetërsohen, trashin zërin, dalin nga vetja, ... Vangjushi ishte dhe mbeti përherë Vangjush; ai thoshte atë që mendonte, ai heshhte kur duhej heshtur, dëgjonte më shumë se fliste, nuk vishte kostumin e rolit nga rekuizita e hipokrizisë, po hynte në lëkurën e rolit e jo vetëm të rolit, po edhe të shokut e të atij që e quante mik me po atë natyrshmëri që hyn njeriu në shtëpinë e vet.

Vangjushi nuk e ndiqte famën si ndjek hija të zotin, nuk gjurmonte dukjen, autoreklamën, krekosjen, nuk lakmonte lavdinë, nuk këmbente arrogancën me autoritetin për t'u dukur më me peshë, se ishte aq i mençur dhe mirëfilli i talentuar sa t'a kuptonte që ato, gradat dhe ofiqet, pozat dhe vetmurrjet - vërtet mund të vijnë së gjalli nga allshverishet e manipulimet, po janë të përkohshme e të padobishme dhe me kalimin e kohës ato, pra lavdia e pamëruar, do të kthehet një ditë edhe kundër të zotit. Sepse Vangjushi e dinte se emri mund të lartësohet vetëm nga talenti, mundi, djersa, vuajtja e sidomos nga puna e ndershme pa kushte e pa shpërblime materiale... Ai nuk hynte kurrë në borxh moral, jo se kishte frikë mos mbetej borxhli, po se kishte dinjitet dhe



Ky është Vangjush FURXHI!

besoim te vetja, paqsa se kjo i sillte vuajtje. I heshtur, si ai, sepse askurrë dhe asnjëherë nuk ju qa shokëve për hallet që ka pasur në jetë, Vangjushit i fliste edhe heshhtja.

I veshur thjesht, e mbaj mend për një kohë të gjatë me të njëjtën xhakëtë, kokulur; punëtor; i vetë mënjauar, njeri që bluante shumë para se të nxirte një fjalë, ai nuk pëlqente të rrinte kafeneve, nuk të fuste kurrë mik për ndonjë hall e nuk pranonte kurrë të përdorej as si "mik" për të bërë nder e favore të pamëruara; ai nuk dilte nëpër gazeta e televizione të jepte mend e të bënte gjykime, madje ai ishte aktori më i vështirë për t'u rekrutuar nga regjisorët për ndonjë rol...

Këtë cilësi të karakterit të tij unë e lidhja jo vetëm me edukatën e tij familjare, po me vetëdijen e një njeriu dhe artisti të vërtetë që nuk do të vjelë nga shoqëria asgjë që nuk e meriton, pasi misioni i çdo artisti të vërtetë, sipas tij, nuk është të vjelë e të marrë sa më shumë, të përkuqsohet e të kushtëzohet nga dëshira për të lënë pas vetëm vlera...

Vangjushi e kishte vuajtje të madhe të vendosje të pranonte një rol, sepse kjo vuajtje do të shoqërohej më pas me një

përgjegjësi e vetvuajtje artistike që vetëm te ai e kam pikasur... Gjithë regjisorët që kanë punuar me Vangjushin mund të pohojnë se sa të vështirë e kanë patur t'a bindnin të pranonte një rol, por ama sa të lehtë e kishin me të pasi ai pranonte të hynte në skenë, për më tepër sa të sigurte ishin ata për suksesin... Po të pranonte Vangjushi rolin, do të thosh që skenari ishte i mirë, jo vetëm roli i tij ishte i mirë, pra edhe sukcesi i filmit do të ishte i garantuar. Prandaj në galerinë e figurave që ka luajtur Vangjushi nuk gjen dot as edhe një rol që mund të thuash që ai ka luajtur dobët, që ai e ka marrë për "plan", si thuhet në atë kohë...

Për këtë arsye Vangjushi ka pak role, krahasuar me mundësitë dhe ofertat, prandaj nuk gjen as edhe një rol që nga këndvështrimi i sotëm mund ta qortosh!

Prandaj e vetmja ndjesi kritike që të vjen pasi e sheh atë në ekran është kjo: - Po pse, o Vangjush, pse nuk na le më tepër role?...

Aq e vështirë ishte që ai të pranonte një rol, sa kish të raste që, për ta detyruar të merrte ndonjë rol, përdroshin edhe "metoda" presioni, të ndyra, deri edhe duke e denoncuar në komitet të partisë, duke thënë se ai nuk e pranon rolin me që... me që "roli

është pozitiv"... Mjerisht, sedra e tij profesionale dhe ndershmëria e tij e jashtëzakonshme, veti këto që sa vjen dhe i gjen shumë rrallë sot, kanë ndikuar, veç të tjerash, edhe për të dëmtuar shëndetin e tij, pas traumës së rëndë që ai pësoi sidomos pas "Njollave të murme"... Pikërisht "Njollat e murme" lanë një njollë të rrëndë e te errëtet në shëndetin e tij, në mënyrën se si ai e shihte jetën, shoqërinë, sepse Vangjushi në të vërtetë kishte një shpirt tepër të brishtë, si të një fëmijë që në vend të zemërimit, më kollaj e ka të rrëfejë habinë.....

Me Vangjushin ndajmë kujtimet e së njëjtës rrugë, rrugës Koço Çaççe në Korçë, prapa kishës Shën Gjergji që më vonë u prish nga themelet e në vend të saj u ngrit një ngrehinë monstrë që u quajt me mburje bibliotekë...

Kemi lindur në të njëjtin vit e që nga kopështi e deri sa mbaruar gjimnazin, kemi qenë përherë bashkë. Madje të dy, jo se ishim harrakatë, madje asokohe kemi qenë nga më të turpshmit e klasës, (më pëlgen ta përsëris këtë: i tillë mbeti Vangjushi deri në fund, paqsa se u bë një nga aktorët më të shquar e më të ndritur të Shqipërisë), ndaj nuk kam drojtë të them se ne, ndonëse nuk bënim prapësira të moshës, prapëseparë mbetëm të dy në klasë, pikërisht në lëndët e artit e cuditërisht edhe në letërsi... Na i kish të marrë asokohe mendjen arti, filmat, letërsia, fatmirësisht, falë prindërve, po me kundërshtimin tonë që buronte nga një sedër tipike korcare, bëmi si bëmi dhe e hëngrëm turpin me bukë dhe pranua të ulemi sërrish në banga me ata që i kishim pasur "nën vete"...

Pra, kemi mbetur në klasë, në vitin e tretë të gjimnazit "Fuat Babani" e kjo ndoshta ka qenë goditja e parë që kemi marrë nga jeta, sepse familjet tona nuk e kishin atë luks që të prisnin edhe një vit më shumë nga dalja jonë në punë, d.m.th në rrogë... Megjithatë prindërit tanë, me sakrificë, na detyruan të hanim turpin me bukë e të nisnin nga e para shkollën. Pa këtë këmbëngulje, ndoshta do të na mungonte Vangjushi në kulturën tonë, sepse ai ndoshta do të kishte mbetur i zhytur në anonimatin e të përalearuarve...

Në shtatëvjeçare kemi luajtur bashkë në një pjesë teatrore; shfaqjen e dhamë në skenën e "Republikës", unë kisha rolin e një plaku, një cigare dhe, më kujtohet vetëm kaq: prapa perdes Kolaqja, një personazh i njohur që shiste biletat e kinemasë, më bënte me shenjë të shuaja cigaren se mos i vija zjarrin skenës... Na dhanë një çmim, do të na jepnin edhe një si certifikatë, të cilën as Vangjushi as unë nuk shkuam ta marrim tek Shtëpia e Pionierit se na vinte turp...

E pra atëherë, kur me Vangjushin sajonim bileta falco për të hyrë çdo ditë në kinema, sepse kinemaja ishte shkolla e vetme që mund të bashkonte asokohe ëndërrën me realitetin, mundësinë me të pamundurën, absurdin me të zakonshmen, urtëjten me dashurinë, nuk na shkente në mend që një ditë Vangjushi do të bëhej një nga artistët më shquar të artit e të filmit shqiptar...

Aq më pak na shkente atëherë mendja se do të vinte një ditë që Vangjushi të mos ishte më mes nesh... Por sytë e tij të gjallë e të zinj dalin nga ekrani sa herë lipset ta kujtojmë dhe me heshhtjen e tij duket sikur na nënërit në vesh këto fjalë: Miq të mi, mund të të tradhetojë kujtesa e shoqërisë, mund të të tradhetojnë shokët, mund të të harrojnë edhe të afermit, po një gjë nuk të harron e nuk të tradheton dot kurrë: Puna dhe talenti yt!

Ky është Vangjush Furxhiu!



TEATER

TEATRI I OPERAS

"Carmina Burana"

Edhe sot në mbremje, ora 19:00, në Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor do të ngjitet baleti "Carmina Burana". Vepra e kompozuar nga Karl Orff, vjeb me koreografi të Arian Sukniqit, me interpretimin e solistëve, korit, trupës së baletit dhe Orkestrës Simfonike të TKOB-së.

AKADEMIA E ARTEVE

"Napoli në Tiranë"

Në datën 8 tetor, ora 18:15 në sallën e Akademisë së Arteve do të promovohet libri i romancierit dhe studiuesit francez Dominique Fernandez, "Porporino, o i Misteri di Napoli", i ftuar nga Instituti Italian i Kulturës. Ndërsa në orën 19:00, programi do të vazhdojë me koncertin e Accademia dei Solinghi, në kuadrin e Stindës Ndërkombëtare Koncertore "Klasik".

TEATRI KOMBËTAR

"Trojanët"

Edhe sot në mbremje në Teatrin Kombëtar, ora 19:00 do të shfaqet drama "Trojanët" me regji të grekut Vangelis Theodoropoulos dhe aktorët Margarita Xhepa, Luiza Xhuvani, Ema Andrea, Rajmonda Bulku, Enesa Dhehemi, Neritan Lica, Guljem Radoja, Arben Derhemi, Marjeta Lajlja, Eftijola Lacka, Loredana Gjeci, Suela Bako, Esmeralda Metka, Adelina Muça etj.



"Skampa 2008" hap dyert për jubileun

Midea" e regjisorit malazez Slobodan Milatović, interpretuar nga aktorët "Teatrit Grup Kotor" të Malit të Zi kanë çelur edicionin e dhjetë të Festivalit Ndërkombëtar Teatror "Skampa-2008". Në këtë vit jubile, qyteti i Elbasanit do të presë 10 trupa teatrore shqiptare dhe të huaja. Drejtori i festivalit, regjisor Adonis Filipi thotë se në 10-vjetorin e tij, ashtu si në edicionet e mëparshme, ky festival shënon "një sfidë artistike dhe menaxheriale të vazhdimësisë së vet". Duke e cilësuar festivalin e këtij viti si një "teatër ndryshe", në prag të çeljes, ai falenderoi Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si dhe Bashkinë e Elbasanit, për mbështetjen që i kanë dhënë kësaj veprimtarie. Veç trupës së qytetit organizues, Teatrit "Skampa", me shfaqjen "Dasma", me regji të Erand Sojlit, do të marrin pjesë dhe

teatri "Dodona" i Prishtinës, me shfaqjen "Kopshti Zoologjik", me regjisor E. Albi, trupa "Bylis" e Fierit, me shfaqjen "Pushtet", me regjisor Adonis Filipi, teatri Migjeni, i Shkodrës, me shfaqjen "Putargat e Thata", të Stefan Çapalikut. Ndër trupat e huaja, përveç asaj të Malit të Zi, janë Teatri Kombëtar "Shtip Maqedonia" me shfaqjen "Gjithandej" me regji të Dejan Prajkovskit, Teatri ASOU-Graz, Australi, me shfaqjen "Origjinë e panjohur", me regjinë e Klaus Seeëald, teatri "Aida Vila Pitest" i Rumanisë, me shfaqjen "Dashuria të dërgon fishekun e fundit", me regji të Luminita Bortas, dhe teatri i Barit (Itali), me shfaqjen "Leksioni i Pianos", me regjisor Karlo Bruni. Përveç Elbasanit, shfaqjet do të ngjiten edhe në Akademinë e Arteve dhe Teatrin Kombëtar në Tiranë.

KINEMA

IMPERIAL

Salla Nr.1

"Iron Man"

Në sallën Nr.1 të kinemasë "Imperial" në Sheraton gjatë javës në vazhdim do të vazhdojë të shfaqet filmi "Iron Man" me regji të Jon Favreau dhe aktorët Robert Downey Jr, Terrence Howard, Jeff Bridges, Gwyneth Paltrow, Leslie Bibb etj. Nga e hëna në të dielë, ora: 10:30-12:30, 13:00-15:00, çmimi i biletës 300 lekë.

"Fools Gold"

Po në këtë sallë do të shfaqet premiera e filmit "Fools Gold" me regji të Andy Tennant dhe aktorët Matthew McConaughey, Kate Hudson, Donald Sutherland, Alexis Dziena, Ewen Bremner, etj. Oraret: 15:30-17:30, 18:00-20:00 (Çmimi i biletës 300 lekë), 20:30-22:30 dhe 23:00-01:00 (Çmimi i biletës 500 lekë).

Salla Nr.2

"Fools Gold"

Në sallën Nr.2 gjatë kësaj jave do të shfaqet filmi "Fools Gold" me regji të Andy Tennant dhe aktorët Matthew McConaughey, Kate Hudson, Donald Sutherland, Alexis Dziena, Ewen Bremner, etj. Oraret: 11:00-13:00, 13:30-15:30, çmimi 500 lekë.

"Gjuetari i balonave"

Po në këtë sallë do të shfaqet filmi "Gjuetari i balonave" me regji të Marc Forster dhe aktorët Khalid Abdalla, Atossa Leoni. Ora 16:00, çmimi 500 lekë.

"Iron Man"

Gjatë mbremjes në sallën Nr.2 do të shfaqet filmi "Iron Man". Oraret: 18:30, 21:00, 23:30, çmimi 600 lekë.

KINEMA



"MILLENIUM 2" TIRANE

"Wanted"

Në kinema "Millenium 2", për publikun e kryeqytetit do të vazhdojë të shfaqet filmi "Wanted" me regji të Timur Bekmambetov dhe aktorët James McAvoy, Morgan Freeman, Angelina Jolie, Terence Stamp, Thomas Kretschmann etj. Nga e hëna deri të premten, ora 10:00, 12:30, 15:00 (çmimi 200 lekë të hënën dhe 300 lekë ditë e tjera. Ora 18:00 dhe 21:00, çmimi 500 lekë.

"MILLENIUM" KORÇE

"Street kings"

Në kinema "Millenium" në Korçë do të vazhdojë të shfaqet filmi "Street kings" me regji të David Ayer dhe aktorët Keanu Reeves, Forest Whitaker, Hugh Laurie, Chris Evans, Cedric the Entertainer etj. Nga e hëna në të premte, ora 17:00 dhe 19:30, çmimi 200 lekë.

"MILLENIUM" ELBASAN

"Sex and the city"

Në kinema "Millenium" në Elbasan edhe gjatë kësaj jave do të vazhdojë të shfaqet filmi "Sex and the City" me regji të Michael Patric King dhe aktorët Sarah Jessica Parker, Kim Cattrall, Kristin Davis, Cynthia Nixon, Chris Noth etj. Ora 11:00, 100 lekë; ora 16:00, 150 lekë; 18:00, 150 lekë dhe 19:00, 200 lekë.

"MILLENIUM" SHKODER


"Rendition"

Në kinema "Millenium" në Shkodër, edhe këtë javë do të vazhdojë filmi "Rendition" me regji të Gavin Hood dhe aktorët Omar Metwally, Reese Witherspoon, Aramis Knight, Rosie Malek-Yonan, Jake Gyllenhaal etj. Orari i shfaqjeve nga e hëna në të diel dhe çmimi i biletave: ora 11:00, 100 lekë, ora 16:00, 150 lekë, dhe ora 18:00, 150 lekë.



Ervin Muçaj sjell "Era ka ndryshuar"

Ndarja vjen një ditë. I prekur nga humbja e bashkëshortes së tij, me të cilën kishte jetuar vite të tëra, një burrë gjen forcën të kapërcëjë dhimbjen. Kjo temë ka ngacmuar realizimin e një filmi të shkurtër artistik "Il vento e cambiato" (Era ka ndryshuar) prodhuar nga Puglia Film Commission me ide, skenar dhe regji të Irvin Muçajt dhe Massimo Federico. Premiera e tij do të shfaqet sot pasdite, ora 18:00 në sallën e vogël të Teatrit Kombëtar. Personazhet e këtij filmi janë aktorët italianë Alberto Rubini dhe Pia Vatcher.



GALERIA KOMBËTARE E ARTEVE

"Sotiri"

Deri në datën 16 tetor në Galerinë e Arteve do të qëndrojnë të ekspozuara fotografi të edicionit të parë të konkursit ndërkombëtar për fotografi të rinj "Sotiri", i cili u mbajt në Korçë më 15 maj – 6 qershor 2008. Janë 60 fotografi të 19 autorëve të rinj nga Austria, Belgjika, Greqia, Holanda, Sinagapori, Maqedonia, Bosnje - Hercegovina, Finlanda, Kosova, Gjeorgjia dhe Shqipëria.

"Rafols-Casamada"

Në sallën Nr.1 të Galerisë Kombëtare të Arteve do të qëndrojnë e çelur ekspozita e piktorit të njohur spanjoll Rafols-Casamada. Janë rreth 40 vepra të artistit, të realizuara në një hark kohor prej 50 vitesh, 1950-2005. Albert Rafols Casamada (Barcelonë 1923) është një nga artistët përfaqësues.

"Re-painting"

Kështu titullohet ekspozita e përkohshme që do të qëndrojë në katin e dytë të GKA-së, aty ku më parë ishin ekspozuar vepra të realizimit socialist. Sali Shijaku, Ksenofon Dilo, Agim dhe Xheneta Kadillari, Skënder Kamberi, Anastas Kostandini kanë pikturuar në mur nga një vepër të tyre të krijuar në kohën e diktaturës.

GALERIA "DIDART"

"Peisazhe Tirane"

Piktori Shkëlqim Kokonozi që prej ditës së nesërme vjen në një ekspozitë personale në galerinë e artit "Didart". E titulluar "Peisazhe Tirane", në të janë ekspozuar 14 punë të piktorit mbi peisazhe të caktuara të kryeqytetit. Pikturat e realizuara në vaj mbi kanavacë i përkasin të gjitha vitit 2008 dhe ekspozohen për herë të parë për publikun. Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri në datën 25 tetor.

GALERIA "KLEDIO"

"E kuqe vatre"

Në galerinë e artit "Zenit" qëndron e hapur ekspozita personale e piktorit kosovar Gani Gashi. Më shumë se 40 piktura janë ekspozuar nën titullin "E kuqe vatre", të realizuara kryesisht dy vitet e fundit.

Shumëkohë në kohë

Tre intelektualë të shquar për Nikolla N. Naçon. Një vepër e Poradecit 77 vjet më parë, botuar në Konstancë të Rumanisë me titull "Një fatos i veteranerisë shqiptare...", qm#hsu#lch#Gu0 pch#arwd#q#hnu#ln#w#5335/#d#w#woc#S#Q#m#o#Q#Q#Q#h#h#N#u#t#h#4;76#U 4<46,#D#r#w#o#h#k#t#l#s#d#l#p#v#h#j#h#q#m#k#t#j#w#i#p#e#l#h#w#h#s#u#t#j#d#h#g#l#h#g#r#d

Nikolla NAÇO

Në letrat e Lasgushit...

REBEKA MARTHA BURDA

Faleminderit Lasgush Poradeci

Lasgush Poradeci, 77 vjet më parë, botoi në Konstancë të Rumanisë broshurën shkencore "Një fatos i veteranerisë shqiptare..." Për botimin e kësaj broshure dhe ribotimin disa herë të saj Lasgush Poradeci pati një letërkëmbim të dendur me mikun e tij Vani Burdën.

Grac, 23 Mars 1932

Fort i nderuar e i dashur mik!

Pikë së pari të kërkoj ndjesë që pushova gjer më sot, me gjithë që shkaku është i largimit tim nga Shqipëria. Djethmaj të dërgova një numër të "Shqipërisë së re" me studimin që kam bërë mbi Kryeveteranin e Lëvizjes sonë Kombëtare në Rumani, dajon tënd të madh Nikollë Naço - Korçën. Studimi përmban vijat themelare të veprës së tij ringjallëse për Kombin tonë. Sapo të jem lehtësuar nga puna e rëndë, do ta zgjeroj studimin më tej, kështu që të krentojme 50 - vjetorin e fillimit të shoqërisë së mësimi shqip "Drita" më 1934 (26 dhjetor), t'i japim popullit shqiptar një fyturë të plotë të mundimeve dhe krijimeve të para të Veteranerisë sonë lavdirënde.

Me shumë të fala. Lasgush Poradeci
Më 1 maj 1932 do të gjendem në Shqipëri.

Tre muaj më vonë Lasgush Poradeci i drejtohet përsëri Vani Burdës në Korçë:

I dashur dhe i shtrenjti!

Është e kotë dhe e tepërt të të siguroj me fjalë, sepse të kam siguruar në zemrën time, që kur të vijë emir yt, do të di të mbush detyrimet siç i ka hije emrit të vërtetë e të pastër të një veterani si ti.

Të lutem, të ma dërgosh me një njeri broshurën e Naços (timen) në Poradec, (sapo ta marrësh këtë shënim), me qenë që sapo të jem në Poradec pasnesër të Hënën, do të filloj ta plotësoj më së miri jetëshkrimin dhe veprën e Naços. Të lutem dërgoma menjëherë.

Të përqafoj me dashuri
Lasgush Poradeci
Tiranë, 12 korrik 1932

Lasgush Poradeci, një nga njohtësit më të mirë të Naços dhe shoqërisë "Drita" të Bukureshtit, e mbyll këtë studim me fjalët e dala prej shpirtit të tij: "... Kjo virtutë e trishme, kjo trini e njëshme e vetijës më përmbajtëse të rracës



Nikolla Naço

s'onë, ish trupëzuar aty përpara gjysmë shekulli tërësisht prej Shtërmadhit Naço. Në çdo kremtim shpirtëror të ditëve të sotme, në çdo Pelerinatë Gjaku të ditëve të nesërme, kremtime dhe pelerinata që lidhin të shkuarën me të arthmen, dyke bërë një tradicion nga shëmbëllat e mara pre të parëve, kanë pjesë me të mbëdhenj e me të vegjël, gjithë Shqiptarët prej një gjaku, të mbledhur përparq tryezës

së përgazëshme që i u shtron Shtërti fisnik dhe zemërgjerë nuk ka pjesë vetëm një njeri: Ay i Cili, që në kohën më të errët të ringjalljes s'onë, pat dhënë gjakun dhe jetën e vet për të paragatitur kremtimin më të madhërishtë nga gjithë kremtimet, kremtimin që është kremtimi i kremtimeve:

Kremtimin e Shpirtit; nuk ka pjesë Ay, i Cili, dyke përvetësuar heroikërisht misionin e frikshëm të organizimit dhe liritimit të një

populli të tërë, krijoi në mes të kaosit t'onë kombëtar Muzikën (ah të përletur!) të shpirtit të tij, dyke bërë Shoqëri "shqipëtare" pa anëtarë shqipëtar. Shkollë "shqipëtare" pa nxënë shqipëtar, Gazeta "shqipëtare" pa këndonjë shqipëtar, Shtypshkronjë "shqipëtare" pa klientë shqipëtar, Kishë "shqipëtare" pa të krishterë shqipëtar, xhami "shqipëtare" pa myslimanë shqipëtar... nuk ka pjesë Burri i Math i Kombit, Dekani

i Flamurtarëve të Veteranerisë, Kriftonjësi dhe Shpirtëzjonjësi plot me famë i Shoqërisë "Drita" Nikollë, N. Naço, i Cili prej mos - shqiptarit gatoi njeriun shqipëtar, dyke na lënë për trashëgim Fyturën e tij Urdhëronjëse, që të ndritet në përjetësi testamenti i Vjershtëorit: "Si trashëgim ju lemë shpirtin t'onë"

Faleminderit Ismet Dërmaku

Më 3 korrik 2002 u bë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë promovimi i librit të Prof. Dr. Ismet Dermaku "Nikolla N. Naço - Korça (1843 - 1913) Apostulli i shqiptarizmit". Këtij studimi Prof. Dr. Ismet Dermaku i ka kushtuar mbi tri dekada punë e kërkime në Bukuresht, Tiranë, Moskë, Leningrad, Sofje etj duke shfletuar qindra e mijëra faqe dokumentash. Në një sallë të mbushur plot, me gjithë se ishte vapë e madhe, akademiku Bedri Dedja mbajti fjalën kryesore duke vlerësuar lart veprën e Prof. Dermakut mbi figurën e Nikolla N. Naços. Ky libër, me përmbajtje të thellë shkencore dhe dokumentare, nxjerr në pah punën e madhe, sakrificat e mëdha për hapjen e shkollave shqipe, gazetave shqipe, përgatitjen dhe shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë të Nikolla Naços.

Faleminderit Bedri Dedja


Nj. Kryevepr. r shkencore p, r Nikolla Naçon.

Prof. dr. Ismet D. rmaku me vepr. n e tij "Nikolla N. Naço - Korça (1843-1913) apostulli i shqiptarizmit" i ngriti nj. lapidar nj. r. s nga figurat m. t. ndritshme t. Rilindjes Komb. tare.

Bedri Dedja

P. r mua, sht. nj. k. naq. si krejt e veçant. q. t. hap diskutimin k. tu n. sall. n e Akademis. s. Shkencave t. Shqip. ris. p. r p. rurimin e kryevepr. s shkencore t. prof. dr. Ismet D. rmaku kushtuar Nikolla Naços, l. vizjes s. Rilindjes Komb. tare dhe historis. s. arsimit dhe t. mendimit pedagogjik shqiptar.

Ne, Koli Xoxi, Iliaz Gogaj dhe un. nuk do ta harrojm. kurr. gjestin patriotik dhe ndihm. n e madhe t. ish - drejtorit t. Arkivit t. Kosov. s. Ismet D. rmakut. n. dhjetor t. vitit 1973, kur nis. m. hulumtimin e par. atje p. r vepr. n madhore "Historia e arsimit shqiptar", e cila u kuror. zua dhe u botua si maket p. r her. t. par. n. vitin 1990. Me kompetenc. n e tij si historian ai na hapi at. here shum. shtigje p. r t. k. rkuar me bujarin. e tij si nj. sh.



Çwç#ç#ç

Grac, 23 Mars 1932
 ...Djethnaj të dërgova një numër të "Shqipërisë së re" me studimin që kam bërë mbi Kryeveteranin e Lëvizjes sonë Kombëtare në Rumani, dajon tënd të madh Nikollë Naço - Korçën. Studimi përmban vijat themelare të veprës së tij ringjallëse për Kombin tonë. Sapo të jem lehtësuar nga puna e rëndë, do ta zgjeroj studimin më tej...



Çwç#ç#ç

Tiranë, 12 korrik 1932
 Të lutem, të ma dërgosh me një njeri broshurën e Naços (timen) në Poradec, (sapo ta marrësh këtë shënim), me qenë që sapo të jem në Poradec pasnesër të Hënë, do të filloj ta plotësoj më së miri jetëshkrimin dhe veprën e Naços. Të lutem dërgoma menjëherë.

qiptar i klas s s, par., duke na shtruar n, tryez, te gjith, thesaret e arkivit q, drejtonte dhe duke na lehtësuar pun, n p r realizimin e q, llimit t, misionit ton., sht, e natyrshme q, nj, zet e n, nt, vjet m, par, ne vet, m mund t, nuhasnim q, ky pun, tor i palodhur i arsimit shqip n, Kosov., do t, b, hej edhe nj, nga historian, t, m, t, shquar t, kombit ton., - çfar, v rretohet kat, reip, risht, tani kur kemi marr, n, duar librin e tij p r Nikolla Naçon.

Trajtim shterues i jet, s s, nj, patrioti.

Vepra "Nikolla N. Naço - Korça (1843 - 1913), apostulli i shqiptarizmit", botuar n, Prishtin, m, 2000, sht, nj, lib, r shum, dimensional, i cili e ka trajtuar gati - gati n, m, nyr, shteruese jet, n dhe vepr, n e patriotit, luft, tarit, diplomatit, publicistit, organizatorit, pedagogut dhe shkenc, tarit shum, t, shquar shqiptar t, gjysm, s s, dyt, t, shekullit XIX dhe fillimit t, shekullit XX, Nikolla Naços t, kolonis, shqiptare t, Bukureshtit. Fjal, n p r k, t, vep, r do t, thon, m, mir, historian, t, si njer, z m, kompetent, se un., Por edhe un, nuk jam krejt inkompetent n, k, t, ç, shtje, sidomos p r historin, e arsimit dhe t, mendimit pedagogjik shqiptar.

Nikolla Naço nuk ka qen, i panjohur p r mua. Por tani q, lexova librin e prof. dr. Ismet D, rmakut p r t., m' u konfirmua plot, sisht idea q, kam pasur n, embrion se Nikolla Naço p r kontributet e tij si organizator i arsimit n, gjuh, n shqipe, n, botimin e librave t, par, shkollor., si drejtor i s, par, s Normale p r r, gdatitjen e m, svesve shqiptar., si kryetar i shqiptar, ve t, Rumanis., i arsimit t, tyre atje, i propagand, s dhe ushtrimit t, fes, n, gjuh, n amtare, meriton pa rezervat, qutet gjenralisimus i arsimit komb, tar. Dhe kjo, sht, reale p r t, karakterizuar n, m, nyr, metaforike figur, n e k, t, gjigandit. I till, t, duket ai, po t, kujtojm, k, tu vet, m dialogun e Nikolla Naços me mbretin Karol I, r, t, Rumansi, n, prani t, kryeministrit Majoresku dhe t, marshalit Robescu. "A, zot, ria juaj, zoti kryetar shqiptar? - Po, si urdh, roni Madh, ri, un, jam kryetari i shqiptar, ve t, Bukureshtit, d, r, nrip i pelazg, ve q, tund, n bot, n sikund r Aleksandri i Madh, Pirroja, Gjergj Kastrioti q, i vun, gardh invazionit turk duke shp, tuar Evrop, n si dhe shume t, tjer, bij t, Shqip, ris., Madh, ri, t, na p, rkrahni dhe t, na ndihmoni q, t, mundemi edhe ne t, lirohemi nga prangar e Turqis, si


dhe t, na jepet vendi p r shkoll., kish, dhe xhami (shqiptare).

Sfida t, reja.

Vepra e Nikolla Naços, sht, n, themel t, t, gjitha shkollave t, para shqipe, n, themel t, pedagogjis, shqiptare t, periudh, s s, Rilindjes. Do t, mjaftonte vet, m normalja "Drita", t, cil, n ai e themeloi duke qen, edhe drejtor i saj, p r t, quajtar at, Promete t, arsimit shqip. Hapja e k, saj shkolle normale mund t, ishte mish, rim vet, m i vizionit t, nj,

pedagogu t, madh. Siç, sht, shprehur vet, Naço: "Pas nj, v, shtir, sie t, madhe n, vitin 1892 arrita t, hapja me mjetet e mia t, parin institut shqiptar k, tu n, Bukuresht, nj, shkoll, normale p r t, p, rgatitur m, sues dhe propagandist., I hapa dyert e shkoll, s duke pritur nx, n, s orthodhoks., katolik, dhe muhamedan., ku do t, merrnin m, sime e ushqim q, m, von, k, ta e nd, rtuan atdheun e tyre, sepse e ngrit, n flamurin e kultur, s n, Shqip, ri, duke

vuajtur n, raste edhe me burje dhe internime." Un, jam plot, sisht dakort me konkluzionit madhor t, prof. I. D, rmakut, i cili k, t, normale e quan universitet. V, rret, ai qe universiteti i par, shqiptar, nx, n, s dhe laureat, t, t, cilit qen, personalitete t, shquara t, aksionit dhe t, mendimit revolucionar si Dervish Hima, Kristo Luarasi, Jashar Erebara, Thoma Avrami, Shahin Kolonja, Mihal Lehova, Mihal Grameno, Asdreni e t, tjer., Me t,



drejt, Mihal Grameno qe shprehur se q, t, num, rohen veprat atdhetare t, Naços duhen libra t, m, dhenj. Kurse Fan Noli p r Naçon qe shprehur: "Ju siguroj q, e quaj veten t' ime fatbardh, q, u poqm, e lidhm, miq, si bashk., se prej kohe d, shironja t, njihnja p r s, af, rmi ushtarin m, t, vjet, r e m, energjik t, çeshtjes shqipe." T, nd, r marr, sh vepra t, tilla, siç, sht, kjo e prof. D, rmakut p r Naçon nuk, sht, as detyr, e lehtë., as detyr, komode. Mua q, n, vitin 1973 m, lan, p, rshlytje t, thell, horizonti i gjer, i k, t, ijt autori si edhe njohja e thell, e historis, s, komunitetit shqiptar t, Rumanis, dhe e problemeve t, historis, s, Rilindjes son, Komb, tare. Ai q, at, here m' u duk zbulues n, "trevat" e k, saj historie.

Prof. D, rmaku i cili i kushtoi pjes, n m, t, madhe t, jet, s k, saj vepre, ka arritur me k, t, nj, nga kuror, zimet m, t, sukseshme t, vepërimitaris, s, vet shkencore, pas botimit t, nj, zet numrave t, "Vjetarit" t, Arkivit t, Kosov, s si kryeredaktor, si profesor ordinar p r historin, n, Fakultetin Filozofik t, Universitetit t, Prishtin, s, si autor i kat, r librave dhe dhjet, ra punimeve shkencore n, revista brenda dhe jasht, vendit, Un, nuk i shteroj dot mendimet e mia p r vep, r e re t, Ismet D, rmakut, aq, m, shum, sot kur d, shirojm, t, flasin edhe koleg, t, tjer., Por nj, mendim e nj, d, shir, p, r mbyll se do ta shpreh. I dashur miku im Ismet D, rmaku! Un, pres tani prej jush zbulimet e t, fsheetat dhe t, panjohurat t, "kontinentit" Naum Veqilharxhi!

(Fjal, e mbajtur n, promovimin e vepr, s s, prof. dr. Ismet D, rmakut "Nikolla N. Naço - Korça, apostulli i shqiptarizmit" mbajtur në korrik të vitit 2002 n, Akademim, e Shkencave t, Shqip, ris, n, Tiran,.)

Xha Naço.

Në këtë vit të 165 vjetorit të lindjes tënde e ndjej për detyrë edhe në emër të kujtimit të gjyshit, Vani Burdës, të mamasë sime Martha Burdës, në emër të sakrificave të Tua dhe të Tyret, të shpreh besimin tek Zoti dhe e Vërteta se familjarisht i dhamë gjithçka këtij vendi, familjarisht e mbajtëm për zemër gjithnjë Shqipërinë e Vërtetë me gjakun tonë, me pasurinë tonë, me sakrificat tona, ndonëse morëm veç plagë e dhembje të shumta dhe heshtje... Një rrugë e vetme e harruar e Korçës mban ende emrin Tënd.


Dhe asgjë tjetër...



Këto tre vizatime, të Gjergj Fishtës i takojnë kohës kur ai ishte ende student dhe janë fotografuar nga fotografi shkrodran Shan Pici. Gjergj Fishta nisi të jepej shumë pas vizatimit në kohën kur merrte mësim në Bosnje gjë e cila dëshmohet, #vlsd#sdyj#Qnq#Nedklw
 S#j#glvd#sqjd#w#lvdwud#x
 vsulkw#m#hw#qjd#nq#h#s#htl#lq/
 su#t#h#j#k#vslw#h#q#nq#h#w#v#k#q
 q#glvs#l#q#s#s#l#u#h#w#q#d#w#k#h#j#d
 h#w#l#q#j#d#w#h#e#x#u#d



Tri vizatime të panjohura të GJERGJ FISHTËS



G#h#w#d#l

Nuk dihet ku mund të jenë sot, por sipas dëshmive të Pader Leon Kabashit, Fishta kur jepte mësim në gjimnazin e jezuitëve kishte realizuar dy piktura peisazhe, të punuara bukur me laps blu, të cilat i kishin varur në rruginën e shkollës.

V#j#q#d#w

Vizatime të tjera të panjohura realizuar nga Fishta, kemi hasur këto ditë, në një botim të hershëm të viteve '40, botuar me rastin e përvjetorit të vdekjes së Fishtës. Këto tri vizatime, i takojnë kohës kur Fishta ka qenë ende student.

ADMIRINA PEÇI

Fakti se At Gjergj Fishta ka qenë edhe piktor, nuk është më i panjohur. Dy vjet më parë, në faqet e "Milosao" kemi botuar një varg vizatimesh e sketch të poetit, një pjesë e tyre marrë nga faqet e fletoreve dorëshkrim të "Lahutës së Malcisë" që ruhet në arkivin e shtetit. Por, kjo anë e krijimtarisë së Fishtës është thuajse e pazbuluar. Vizatime të tjera të panjohura kemi hasur këto ditë në një botim të hershëm të viteve '40. Këto tri vizatime i takojnë kohës

kur Fishta ka qenë ende student. Dy portretet vendosur përballë njëri-tjetrit, djaloshi me kostum kombëtar, pushkë në sup e qeleshe në kokë, si dhe kjo natyrë e qetë, të befasojnë me qartësinë dhe natyrshmërinë e linjave. Pader Leon Kabashi, ish-nxënës i Fishtës, i cili e ka studiuar në thellësi kontributin e Fishtës në arte, shkruan në një botim të 1943-it, se "Gjergj Fishta është një ndër prodhuesit, udhëheqësit dhe nxitësit kryesor të arteve të bukura në Shqipëri. E them këtë jo vetëm se e kam ndier, por sepse kam pasur fa-

tin të marr mësim e të drejtohem prej tij, për disa kohë dhe raste të ndryshme në Shqipëri dhe jashtë saj. Gjergj Fishta deshi të realizonte të gjitha ato që i ndjente, por jo për faj të tij, hovet psikike e ndeshën me vështirësi të vendit, kohën dhe mjetet e megjithëkëtë i përballoi, se kjo është një veti kryesore e një artisti". Duket, që në fëmijërinë e tij Fishta do i ketë pasur në gjak për përparimet e ndryshme, i nxitur sidomos prej françeskanit italo-shqiptar, Leonard de Martino, si dhe të tjerëve që shihnin te ai cilësi fenomenale.

Kabashi shkruan se në Bosnje, Fishta pati rastin të shohë ndryshimet prej vendit të tij. Atje u dha shumë pas vizatimeve, gjë e cila dëshmohet, sipas padre Leon Kabashit, "nga disa punime të ruajtura ku shprehet jo vetëm me kujdes e precizion, por që edhe shpirti i mendja e tij ishin në dispozicion apo prirje të natyrshme nga estetika dhe artet e bukura". Po në këtë botim, nga ku i kemi marrë këto tri vizatime, Kabashi na jep dhe një fakt mjaft domethënës për dy piktura të plota të Fishtës, të cilave sot nuk iu dihet fati. Kabashi kujton se

"dy pikturat peizazhe të Fishtës, varur në rruginën e shkollës, të punuara bukur me laps blu, për ne, mijëra fëmijë, veshur, dikush me bradavekë e dikush me braktesha, ishin një nxitje e pandërprerë për edukimin e artit". Këto tri vizatime këtë anë prej artisti në krijimtarinë e Fishtës. Vizatimet janë fotografuar nga i mirënjohuri fotograf i Shkodrës, Shan Pici, falë të cilit kanë mbërritur deri në ditët e sotme. Origjinalet e tyre, s'dihet nëse ruhen ende, diku.